

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6051
E mërkurë, 1 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Kushtetuesja e shpallë të pavlefshëm Ligjin për Paga



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM KRASNIQI | FAQE 4-5

ZBATIMI I PLOTË I PAKOS EMERGJENTE VARET NGA RISHIKIMI I BUXHETIT



Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, ka thënë se janë duke shikuar të gjitha mundësitë për zbatimin e pakos emergjente. Krasniqi në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka thënë se zbatimi i plotë i pakos

emergjente ekonomike varet nga rishikimi i buxhetit. "Jemi duke bërë përpjekje që të lirojmë mjete. Do të vazhdojmë të paguajmë edhe një pjesë të punëtorëve, por që të përfundojë e gjithë pakaja jemi duke pritur procesin

e rishikimit të buxhetit të shtetit", është shprehur Krasniqi. Ai ka thënë se nëse nuk ndodhë rishikimi i buxhetit do t'i diskutojnë modalitetet për sigurimin e fondeve për zbatimin e pakos emergjente

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA, KA PËRFUNDUAR VIZITËN DYDITORE NË KOSOVË

Rama: Pa Thaçin, Veselin, Haradinajn dhe të tjerët, mund të mos e kishim Kosovën e pavarur.



OPINION

NDRYSHIMET
E KUFIJVE
TË KOSOVËS
1945-1959 F. 11



Shkruan: Mentor TAHIRI

AKTUALE



NË KLINIKËN INFektIVE JANË
TË SHTRIRË 111 PACIENTË ME
COVID-19 F. 6

UP-SË I VAZHDOHET AKREDITIMI
EDHE PËR PESË VJET F. 5

PODUJEVA DO TË BËHET ME
SPITAL TË PËRGJITHSHËM F. 10

EKONOMI



NËNSHKRUHET MARRËVESHJA
1 MILION E 500 MIJË EURO PËR
T'I NDIHMUAR BIZNESET F. 8

OAK-U KËRKON PËRKRAHJE NGA
PARTITË POLITIKE NË KUVEND
PËR TEJKALIMIN E KRIZËS F. 8

SPORT

YMERI: DRENICA E KA VENDIN
NË SUPERLIGË F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Gjermania mund ta vendosë në agjendë liberalizimin e vizave për Kosovën

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Kryesimin e Këshillit të Bashkimit Evropian e përfundon të martën në mesnatë Kroacia, ndërsa nga sot (e mërkurë) do t'i takojë Gjermanisë. Presidenca gjermane do ta ketë prioritet kryesor miratimin e kornizës shumëvjeçare financiare dhe fondit për përballje me pasojat e pandemisë. Por, sipas një diplomati të lartë gjerman, në rend dite do të ketë edhe tema të tjera.

Disa deputetë të Parlamentit Evropian i kanë shkruar kancelares gjermane Angela Merkel, që gjatë kryesimit të tyre me BE-në të vendosin në rend dite edhe liberalizimin e vizave për Kosovën pasi, sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, Kosova i ka përbushur të gjitha kushtet e kërkuara.

Një diplomat i lartë gjerman u ka thënë gazetarëve se për liberalizimin e vizave kërkohet një shumicë e kualifikuar e vendeve anëtare në Këshillin e BE-së dhe se, nëse Gjermania vlerëson se ekziston një shumicë e tillë, atëherë do ta vendosë në rend dite. "Nëse e shohim se nuk ka shumicë të kualifikuar atëherë do të vazhdojmë të punojmë prapa skenës", ka thënë ky diplomat gjerman, shkruan "Radio

Evropa e Lirë".

Zyrtarë të lartë gjermanë janë shprehur publikisht në favor të liberalizimit të vizave për Kosovën. Por, Franca, Holanda dhe disa shtete të tjera të BE-së nuk e kanë mbështetur deri më tash një vendim të tillë. Pas liberalizimit të vizave, Gjermania dëshiron që gjatë kryesimit të saj me BE-në të avancojë edhe dialogu mes Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian. "Ka ardhur koha që të ketë lëvizje pozitive në këtë drejtim gjatë këtij viti. BE-ja është e gatshme ta luajë rolin e saj në lehtësimin e arritjes së një marrëveshjeje në mënyrë që të ketë progres edhe në procesin e integrimi evropiane", ka thënë një diplomat i lartë gjerman. Gjermania do të tentojë që gjatë presidencës së saj të BE-së t'i nisë edhe negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Por, diplomat i lartë gjerman tërhoqi vërejtjen se në këtë drejtim nuk mund të ketë garanci. Ai tha se do të jetë më lehtë në rastin e Maqedonisë së Veriut sesa Shqipërisë, por Gjermania do të tentojë ta avancojë edhe këtë temë. Për secilin hap në procesin e zgjerimit, vendimet miratohen me pajtimin e të gjitha shteteve anëtare.



Ambasadori italian: Është koha të ndodhë liberalizimi i vizave për Kosovën

Ambasadori i Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, ka uruar Gjermaninë për marrjen e Presidencës së Bashkimit Evropian. Me këtë rast, Orlando ka thënë se pret që shumë shpejtë të ndodhë liberalizimi i vizave për Kosovën. "Faleminderit Kroacisë për semestrin e shkëlqyer dhe fat të mbarë Gjermanisë në kryesimin e saj të BE-së!

Siç tha kryeministri Giuseppe Conte në Zagreb: "Së shpejti presim liberalizimin e vizave për Kosovën. Shpresoj që të gjitha vendet anëtare të BE-së hezituese të lejojnë që liberalizimi i vizave të ndodhë gjatë semestrit. Është koha", ka shkruar Orlando në llogarinë e vet në "Twitter".

BE-ja synon ta vazhdojë dialogun Kosovë - Serbi pa presidentin Thaçi

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Zyrtarët e Bashkimit Evropian (BE) synojnë t'i vazhdojnë përpjekjet për rifillimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, por në këto plane nuk e përfshijnë më presidentin Hashim Thaçi, i cili i ka udhëhequr negociatat me Serbinë në emër të Kosovës për vite me radhë.

Zyrtarët e BE-së kanë njoftuar se pas këtyre zhvillimeve ata nuk e konsiderojnë më presidentin e Kosovës një partner në procesin e dialogut. "Në reagimet tona deri më tani, ne kemi thënë, midis rreshtave, se do të ishte më mirë që ai (Thaçi) të përqendrohet në aktakuzën e tij dhe se derisa çështja të zgjidhet, pra të ketë një aktgjykim, nga ana e BE-së do të ketë shumë pak ndërveprim me të", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" një zyrtar evropian që merret me procesin e dialogut



Kosovë - Serbi. Në çdo rast, BE-ja vlerëson se Prishtina zyrtare do të vazhdojë të jetë e përkushtuar për dialog, pavarësisht se kush e zhvillon atë në emër të Kosovës. "Nuk i takon BE-së t'i zgjedhë bashkëbiseduesit, por i takon palës kosovare të vendosë kush

do t'i përfaqësojë më së miri interesat e tyre", ka thënë Virginie Battu-Henriksson, një zëdhënëse e BE-së.

BE-ja synon që së shpejti të organizojë një samit në Paris, ku do të takohen delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë. Nikoqirë

do të jenë presidenti i Francës, Emanuel Macron, dhe kancelarja gjermane Angela Merkel. Takimi ka të ngjarë të mbahet më 10 korrik. Kjo datë është caktuar para njoftimit për aktakuzën kundër presidentit të Kosovës. Sipas zyrtarëve nga Berlina,

rrethanat aktuale politike në Prishtinë nuk do ta ndryshojnë agjendën e samitit, por ato sigurisht se do të ndikojnë në ndryshimet në listën e mysafirëve, që do të thotë se presidenti i Kosovës nuk do të ftohet në Paris. Një zyrtar gjerman u ka thënë gazetarëve se ata shpresonin që BE-ja t'i forconte përpjekjet për ta përparuar çështjen e dialogut dhe të arrijë një marrëveshje midis Serbisë dhe Kosovës. Javën e kaluar një prokuror i specializuar në Hagë ka thënë se ka paraqitur aktakuzë kundër presidentit të Kosovës, nën dyshimin se është i përfshirë në krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Thaçi ka vendosur të qëndrojë në pozitën e presidentit, duke thënë se ai do të jepte dorëheqje vetëm nëse konfirmohen pretendimet në aktakuzë nga ana e gjykatës të procedurës paraprake.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përfunduar vizitën dyditore në Kosovë

Rama: Pa Thaçin, Veselin, Haradinajn dhe të tjerët, mund të mos e kishim Kosovën e pavarur

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se vizita e tij në Kosovë është zhvilluar në funksion të një nevoje kombëtare. Në një konferencë për media në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", pak para se të largohej nga Kosova, Rama ka përsëritur se pa Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Ramush Haradinajn dhe të tjerët mund të mos e kishim Kosovën e pavarur. Kryeministri Rama ka folur edhe për Shengenin Ballkanik, të cilin e ka vlerësuar interes strategjik të Shqipërisë dhe Kosovës



Mustafa: Ardhja e Ramës në Prapashticë ishte shenjë kujdesi dhe nderi veçantë

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar për takimin e tij me kryeministrin shqiptar Edi Rama. "Kisha nderin të takohem me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, e të bashkëbisedojmë për shumë tema aktuale. Ardhja e tij në Prapashticë, ku po qëndroj tani, ishte shenjë kujdesi dhe nderi veçantë për mua dhe familjen time", ka shkruar Mustafa.

Shengen Ballkanik, interes strategjik i Shqipërisë dhe Kosovës

Në fjalën e tij gjatë konferencës për media, kryeministri Rama ka folur edhe sa i përket Shengenit Ballkanik. "Unë mbetem ai që kam qenë dhe jam ai që jam. Mendoj se kush nuk ndryshon mendim s'është domosdoshmërisht një njeri i mençur, por Shengen Ballkanik është interes strategjik i Shqipërisë dhe Kosovës. Sikur të mos kishim humbur kohë me lloj-lloj konspiracionesh, kufiri aty do të ishte sikur vjen nga Prishtina këtu në aeroport. S'do të kishte asnjë kontroll për arsyen se kjo është mundësuar falë negociatave me presidentin e Serbisë dhe në këtë proces s'duhet të harrojmë që jemi në paqe dhe në paqe duhet t'i kemi korsitë e ndara edhe për pjesën e trajtimit të krimeve të luftës, edhe për aspektet ekonomike dhe sociale. Shengen Ballkanik është interes strategjik i shqiptarëve.

Me Shengenin Ballkanik të gjitha vendet, Shqipëria dhe Kosova, kanë hyrje dhe dalje të përbashkëta. Kush hyn në aeroportin 'Adem Jashari' është i lirë të lëvizë deri në Sarandë pa u kontrolluar", ka thënë Rama. Vizita dhe komentet e Ramës pasojnë njoftimin e javës së kaluar të Zyrës së Prokurorit Special, se ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, dhe të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë. Rama gjatë vizitës në Kosovë është takuar me presidentin Hashim Thaçi, kryeparlamentaren Vjosa Osmani, kryeministrin Avdullah Hoti, kryetarin e LV-së, Albin Kurti, kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli, kryetarin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj dhe atë të AKR-së, Behgjet Pacolli. Por, nuk ka ndodhur një takim në mes të Ramës dhe liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj.

EPOKA
ERE

Muhamet Koci

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka përmbyllur të martën vizitën dyditore në Kosovë. Rama në përmbyllje të vizitës ka mbajtur edhe një konferencë për media në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" në Prishtinë, në të cilën ka folur për takimet që ka pasur me liderët shtetërorë dhe partiakë në Prishtinë. Ai ka theksuar se vizita e tij në Kosovë është zhvilluar në funksion të një nevoje kombëtare. "Dua ta bëj të qartë



faktin se jam këtu, në funksion të një nevoje kombëtare, për t'i dhënë mbështetje të plotë Kosovës dhe të gjithë përfaqësuesve politikë në kushtet kur ka ndodhur diçka e rëndë dhe thellësisht e padrejtë", ka deklaruar Rama.

Rama edhe në këtë konferencë i cilësoi aktakuzat për krime lufte

nga Prokuroria e Hagës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit si metodë brutale dhe diskriminuuese. "Nëse do të ishte aktakuza unë nuk do të isha sot këtu, s'do flisja në parlament dhe besoj se, si çdokush tjetër, pavarësisht se çfarë do të mendoja, do të isha i detyruar ta prisja me durim procesin, po unë s'po flas për aktakuzën, po flas për një fletërrufe, një brutalitet ndërkombëtar. Dhe kush nuk e sheh si të tillë, ose është naiv ose ka shumë mllef", ka thënë ai.

Ai ka shtuar se po mos të ishte UÇK-ja, Kosova mund të mos ishte shtet i pavarur sot. Sipas tij, Kosova e pavarur nuk do të ishte pa Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Ramush Haradinajn dhe ushtarët e tjerë të UÇK-së. "Është një privilegj i krijuar falë UÇK-së, se mund të mos kishim jo dy shtëpi sot, por mund të mos kishim Kosovën e pavarur dhe demokratike. Shumëkush mund ta ketë harruar apo mund të pëtojë t'i kthehet historisë dhe të shohë se në çfarë konteksti u zhvillua rezistenca e popullit të Kosovës që nga lëvizja gandiane e Ibrahim Rugovës te lufta çlirimtare. Për shumëkënd, natyrshëm kanë kaluar shumë vite. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj apo të tjerë mund të shihen thjesht me sytë e atyre që bënë apo nuk bënë, sa dhe si duhet në qeverisje, por ajo çka sot duhet kujtuar me forcë, është se pa këta emra të përveçëm dhe të tjerë bashkë me ta sot mund të mos kishim as Kosovën e pavarur dhe shtet sovran dhe jo më dy shtëpi. Një këtëj bjeshkëve dhe një andej bjeshkëve", ka thënë Rama.



Pacolli në takim me Ramën: Skena politike shqiptare duhet të unifikohet

Presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, është takuar të martën me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Pas takimit Pacolli ka thënë se me Ramën shkëmbyen mendime mbi zhvillimet e fundit dhe ranë dakord që scena politike shqiptare duhet të unifikohet përballë padrejtësisë ndërkombëtare. "Si komb duhet t'u përgjigjemi përpjekjeve për ta rishkruar historinë tonë. Serbia është agresorja. Është ajo që ka vrarë dhe masakruar më shumë se 12 mijë civilë të pafajshëm në Kosovë dhe ka kryer më shumë se 400 masakra nga më çnjerëzoret", ka thënë Pacolli.

Rama thotë se do ta tërheqë padinë ndaj Haradinajt

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë të martën se do të tërheqë padinë ndaj ish-kryeministrit, njëherësh kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj. "Do ta tërheq padinë, jo se ajo është e vogël për mua, por sepse është shumë më e madhe ajo që sot duhet t'i bashkojë të

gjithë", është shprehur Rama në konferencën për media në Prishtinë, në përfundim të vizitës së tij dyditore në Kosovë.

Në mes të muajit janar Gjykata Themelore në Prishtinë ka konfirmuar se kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ka dorëzuar padi kundër kryeministrit në detyrë të Republikës

së Kosovës, Ramush Haradinaj. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Civile, më 15 janar 2020 kishte njoftuar se ka pranuar padinë nga paditësi Edi Rama kundër të paditurit Ramush Haradinaj për kompensim dëmi për shkak të deklaratës shpifëse të supozuar nga paditësi. Rama pretendonte se

Haradinaj ka shpifur me deklaratat e tij që i ka dhënë në lidhje me temën e shkëmbimit të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Haradinaj kishte deklaruar se "padija e kryeministrit Rama është plotësisht e pabazuar dhe një diversion politik që bëhet nga ana e tij, që të fshihet pas dramave mediale dhe t'i ikë përgjegjësisë".



Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, kryeministri Rama ka takuar të gjithë liderët politikë dhe institucionalë, por jo edhe kreun e AAK-së, Ramush Haradinaj.

FLET PËR “EPOKËN E RE”, AGIM KRASNIQI

ZBATIMI I PLOTË I PAKOS EMERGJENTE

Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, ka thënë se janë duke shikuar të gjitha mundësitë për zbatimin e pakos emergjente. Krasniqi në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re” ka thënë se zbatimi i plotë i pakos emergjente ekonomike varet nga rishikimi i buxhetit. “Jemi duke bërë përpjekje që të lirojmë mjete. Do të vazhdojmë të paguajmë edhe një pjesë të punëtorëve, por që të përfundojë e gjithë pakoja jemi duke pritur procesin e rishikimit të buxhetit të shtetit”, është shprehur Krasniqi. Ai ka thënë se nëse nuk ndodhë rishikimi i buxhetit do t’i diskutojnë modalitetet për sigurimin e fondeve për zbatimin e pakos emergjente

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Zëvendësministri i Financave, Agim Krasniqi, ka thënë se zbatimi i plotë i pakos emergjente ekonomike varet nga rishikimi i buxhetit të shtetit nga ana e Kuvendit të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epokën e re”, Krasniqi ka thënë se janë duke i shikuar të gjitha mundësitë që të zbatohet kjo pako, nga e cila përftojnë edhe punëtorët e sektorit privat. “Jemi duke u munduar ta bëjmë këtë në bazë të ligjit, duke bërë edhe ndonjë lirim të mjeteve mbi bazën e buxhetit origjinal. Me fjalë të tjera, bashkërisht me ministrinë tonë jemi duke bërë përpjekje të lirojmë mjete. Do të vazhdojmë ta paguajmë edhe një pjesë të punëtorëve, por që të përfundojë e gjithë pakoja ne jemi duke pritur procesin e rishikimit të buxhetit të shtetit”, ka deklaruar Krasniqi. Ai ka bërë me dije se për shkak të mosrishikimit të buxhetit një

pjesë e pagesave që dalin si obligime nga pakoja emergjente do të jenë të pamundura të bëhen. “Në rast se shtyhet rishikimi i buxhetit, do të mbesin një pjesë e masave pa u paguar. Një gjë e tillë do të vlejë deri në kohën e rishikimit të buxhetit dhe pas aprovimit të rishikimit të buxhetit nga Kuvendi ne si ministri do t’i përfundojmë të gjitha pagesat”, është shprehur Krasniqi.

Më tutje, Krasniqi ka folur edhe rreth mundësisë së hyrjes në borxh publik për ta zbatuar pakon emergjente ekonomike. Në kontekst të kësaj, Krasniqi ka përmendur edhe marrëveshjet financiare ndërkombëtare të cilat Kuvendi i Kosovës nuk është duke arritur t’i ratifikojë. “Në rast se nuk ndodhë rishikimi i buxhetit dhe nuk ratifikohen marrëveshjet ndërkombëtare ne duhet të kthehemi mbrapa dhe të diskutojmë mbi modalitetet se si t’i sigurojmë fondet. Kjo nuk do të thotë se automatikisht ne do të hyjmë në borxh publik, por duhet t’i



UP-së i vazhdohet akreditimi edhe për pesë vjet

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Republikës së Kosovës (KShC) ka analizuar dhe votuar raportet e ekspertëve ndërkombëtarë mbi vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë. Sipas votimit të KShC-së, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është riakredituar për pesë vjetet e ardhshëm. Ndonëse e ka konsideruar si vendim të pritur, rektori i UP-së, prof. dr. Marjan Dema, është shprehur i lumtur që ky universitet ka marrë vlerësim të lartë nga ekspertët ndërkombëtarë dhe është

votuar për akreditimin e tij edhe për gjysmë dekadë. Për këtë vendim të rëndësishëm, Dema ka uruar studentët, stafin dhe të gjithë qytetarët. “I gëzohem shumë vendimit të KShC-së për riakreditimin e UP-së edhe për pesë vjet. Ashtu si vendimi, edhe vlerësimi në detaje i performancës së UP-së kanë konstatuar që UP-ja ka shënuar përparime të mëdha dhe vazhdon të jetë institucion lider i arsimit të lartë. Me këtë rast, për zemërsisht i uroj studentët, profesorët, stafin akademik dhe të gjithë qytetarët e këtij vendi, sepse Universiteti i



Prishtinës është i të gjithëve”, ka thënë Dema. Përveç urimeve, rektori Dema ka falënderuar stafin akademik dhe

administrativ, menaxhmentet e fakulteteve, studentët dhe partnerët për punën e palodhshme të bërë për ngritjen

e cilësisë së institucionit si dhe për akreditimin e tij në veçanti. Procesi i vlerësimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë në Universitetin e Prishtinës është zhvilluar në maj të këtij viti, duke qenë njëherësh i pari institucion vendor i vlerësuar përmes një procesi të mbajtur tërësisht online. Për riakreditimin e Universitetit të Prishtinës, ekspertët kanë mbajtur takime dhe e kanë vlerësuar institucionin në nivele të ndryshme, duke filluar nga ai menaxherial, akademik dhe administrativ, si dhe nivelin e studentëve.

VARET NGA RISHIKIMI I BUXHETIT

rishikojmë shpenzimet aktuale dhe ta rishikojmë ndoshta edhe pakon për rimëkëmbje ekonomike. Mundësi tjetër është edhe pjesa e borxhit publik, por kjo mundësi është kufizuar pasi ekziston rregulla që është aprovuar në buxhetin e shtetit, ku saktësohet se deficitit buxhetor të mund të shkojë në 6 për qind”, ka theksuar Krasniqi.

“Epoka e re”: Z. Krasniqi, kur pritet të dalin 170 eurot e premtuara nga Qeveria e Kosovës për punëtorët e sektorit privat për muajin e dytë në kuadër të pakos emergjente?

Krasniqi: Ne jemi duke bërë përpjekje për t’i shikuar të gjitha mundësitë rreth kësaj çështje. Pra, jemi duke u munduar ta bëjmë këtë në bazë të ligjit, duke bërë edhe ndonjë lirim të mjeteve mbi bazën e buxhetit origjinal. Me fjalë të tjera, bashkërisht me ministrinë tonë jemi duke bërë përpjekje të lirojmë mjete ku do të vazhdojmë të paguajmë edhe një pjesë të punëtorëve, por që të përfundojë e gjithë pakoja ne jemi duke pritur procesin e rishikimit të buxhetit të shtetit.

“Epoka e re”: Duke marrë parasysh rrethanat aktuale për shkak të pandemisë Covid-19 dhe shtyrjen e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, në të cilën pritej të vendosej për caktimin e datës për mbajtjen e seancës për rishikimin e buxhetit, çfarë do të ndodhë nëse do të ketë vonesa? Në këtë kontekst, mund të na tregoni pse kanë mbetur vetëm punëtorët e sektorit privat pa u paguar nga pakoja emergjente?

Krasniqi: Ministrinë janë të ndara dhe secila ministri ka përgjegjësinë për zbatimin e masave të cilat janë pjesë e

pakos. Përderisa nuk ka riorganizim të ri mbetet buxheti që ka qenë. Mirëpo, aktualisht ne jemi duke shikuar për t’i gjetjen e ndonjë mundësie për ta liru ndonjë fond për të bërë pagesa për atë që kemi mundësi. Por, realisht, duhet të kryhet rishikimi i buxhetit për ta zbatuar pjesën që ka mbetur. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) vazhdon ta paguajë pjesën e skemave sociale nga masa 15 e pakos emergjente, e cila ka të bëjë me të papunët. Për të përfunduar në tërësi pakoja duhet të bëhet rishikimi, pasi e dimë saktë se nuk kemi mundësi brenda kufizimeve ligjore për t’i përfunduar masat. Në rast se shtyhet rishikimi i buxhetit një pjesë e masave do të mbesin pa u paguar. Një gjë e tillë do të vlejë deri në kohën e rishikimit të buxhetit dhe pas aprovimit të rishikimit të buxhetit nga Kuvendi ne si ministri do t’i përfundojmë të gjitha pagesat.

“Epoka e re”: Z. Krasniqi, Kuvendi i Kosovës dy herë radhazi nuk ka arritur t’i ratifikojë disa marrëveshje financiare ndërkombëtare. Mosratifikimi i këtyre marrëveshjeve, a paraqet rrezik që punëtorët mos t’i marrin këto paga dhe a jeni duke e rishikuar mundësinë të hyni në borxh publik?

Krasniqi: Në rast se nuk ndodhë rishikimi i buxhetit dhe nuk ratifikohen marrëveshjet ndërkombëtare ne duhet të kthehemi mbrapa dhe të diskutojmë mbi modalitetet se si t’i sigurojmë fondet. Kjo nuk do të thotë se automatikisht ne do të hyjmë në borxh publik, por duhet t’i rishikojmë shpenzimet aktuale dhe, ndoshta, të rishikojmë edhe pakon për rimëkëmbjen ekonomike. Mundësi tjetër është edhe pjesa e borxhit publik, por kjo mundësi është kufizuar pasi ekziston rregulla që është aprovuar në buxhetin e shtetit, ku saktësohet se deficitit buxhetor mund të shkojë në 6

për qind. Ne mund të hyjmë borxhe deri në 40 për qind të Bruto Produktit Vendor (GDP), por nuk mund ta kalojmë gjashtëpërqindëshin e deficitit buxhetor. 6.5-përqindëshi i deficitit buxhetor nuk lejon që në vitin e parë ta arrish as në 30 e as 40-përqindëshin e borxhit. Po t’i shikoni tabelat e rishikimit të buxhetit, për shkak të rregullores së deficitit, shohim se ne nuk mund të marrim më shumë borxh sesa e lejon deficitit.

“Epoka e re”: Në rast se do të kemi rënie të GDP-së, respektivisht rënie ekonomike, a do të ketë ulje të pagave për punëtorët e sektorit publik?

Krasniqi: Duhet të bëhet rishikimi i buxhetit dhe, varësisht nga nevojat, duhet të rishikohet edhe mundësia e uljes së shpenzimeve. Nuk dua të keqkuptohem e as të specifikohem te punëtorët e sektorit publik, por në tërësi duhet të rishikohet mundësia e uljes së shpenzimeve publike.



Kushtetuesja e shpallë të pavlefshëm Ligjin për Paga



PRISHTINË, 30 QERSHOR - Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për Paga në Sektorin Publik. Sipas vendimit, ligji nuk është në përputhshmëri me 11 nene të Kushtetutës së Kosovës.

Ligjin për Paga më 6 dhjetor të vitit të kaluar në Gjykatën Kushtetuese e ka dërguar institucioni i Avokatit të Popullit për, siç thuhet, “vlerësimin e përputhshmërisë” së këtij ligji me Kushtetutën. Kurse Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kishte vendosur që të pezullohet zbatimi i këtij ligji

deri më 30 mars 2020.

Ligji për Paga është miratuar në muajin shkurt të vitit 2019, kurse në fillim të muajit mars patë hyrë në fuqi. Sipas ligjit të ri, paga bazë është ajo pjesë e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë të një funksioni apo pozite të caktuar. Vlera e pagës bazë llogaritet duke shumëzuar koeficientin e klasës së pagës me vlerën monetare të koeficientit. Raporti i koeficienteve është një me dhjetë (1:10), të shpërndarë në gjashtëdhjetë e nëntë (69) nivele të koeficienteve. Koeficienti më i

lartë është 10, pozitë kjo që e mban vetëm presidenti i Republikës së Kosovës, më pas është niveli 9, ku bëjnë pjesë kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Ligji për Paga rregullon rritjen e pagave për 70 për qind të punëtorëve në sektorin publik, kurse 30 për qind mbeten jashtë. Por, punonjës në sektorë të ndryshëm publikë kishin shprehur pakënaqësitë lidhur me përcaktimet dhe përfshirjen e tyre në ligji.

Nis hartimi i Strategjisë Kundër Korrupsionit 2021-2025

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, ka diskutuar me drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shaip Havolli, për procesin e fillimit të hartimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit për periudhën 2021-2025.

Zëvendëskryeministri Tahiri do të udhëheqë dhe drejtimin strategjik për procesin e hartimit të strategjisë, si një nga prioritetet kryesore të

punës së tij. Zëvendëskryeministri Tahiri ka theksuar nevojën që procesi i hartimit të kësaj strategjie të jetë gjithëpërfshirës, duke përfshirë institucionet qendrore dhe lokale, shoqërinë civile, mediat dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Zëvendëskryeministri Tahiri ka deklaruar se ka diskutuar me krerët politikë dhe institucionale, duke përfshirë edhe partnerët ndërkombëtarë, për ta sig-

uruar mbështetjen, por edhe konsensusin shoqëror dhe politik për luftimin e korrupsionit në nivel të vendit.

Strategjia e re Kundër Korrupsionit do të mbështetet në katër shtylla: 1) Sektorin politik publik; 2) Administratën shtetërore (nivele qendror dhe lokal); 3) Zbatimin ligjit dhe gjyqësorit; dhe 4) Menaxhimin e financave publike.

Kjo qasje strategjike siguron trajtimin e sfidave në fushën e korrupsionit, të



identifikuara përmes vlerësimit të rrezikut ndaj korrupsionit të zhvilluar për sektorë të caktuar, të cilat janë zhvilluar nga projektet mbështetëse në këtë fushë.


Ministri Selimi: Qasja në drejtësi, një nga prioritetet e planit tim qeverisës

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka marrë pjesë në takim virtual të organizuar nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), mbështetur nga aktiviteti i USAID-it "Drejtësia vlen", ku është diskutuar rreth sfidave që janë identifikuar nga ANJF, në veçanti gjatë periudhës së fundit në raport me situatën e krijuar nga masat e ndërmarra për parandalimin e Covid-19. Ministri Selimi gjatë këtij takimi ka thënë se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas është institucion i rëndësishëm përmes të cilit qytetarët sigurojnë qasje efikase në sistemin e drejtësisë dhe shërbime juridike falas. "Mbrojtja juridike falas është e domosdoshme për grupet e ndjeshme dhe të marginalizuara, të cilat mund të këshillohen apo të shikojnë se si të kenë barazinë e palës brenda procesit", është shprehur Selimi.

Sipas ministrit Selimi, qasja në drejtësi është një nga prioritetet e planit të tij qeverisës. "Qasja në drejtësi për ne ende është një çështje në të cilën duhet të punojmë qoftë për shkak të stigmatizimit social, të pengesave gjeografike apo çështjeve të tjera të cilat



pengojnë që të gjithë qytetarët të kenë qasje në drejtësi në mënyrë të barabartë", ka deklaruar ministri Selimi.

Ministri Selimi ka pohuar se është e rëndësishme të avancohet infrastruktura ligjore për çka falënderoi GIZ-in dhe USAID-in për ndihmë,

ndërsa ka potencuar që krahas kësaj e rëndësishme është edhe infrastruktura institucionale. "Në qoftë se një person në nevojë nuk mund t'i qaset drejtësisë, atëherë drejtësia duhet t'i ketë mekanizmat që të jetë e qasshme për të jo për shkaqe humanitare, por për

shkaqe të sjelljes së domosdoshme të drejtësisë në vendin e vet. Është shumë e rëndësishme që ANJF t'i ketë kushtet e mira, si ato kadrovikë, logjistike, por edhe të dijës dhe kapacitetit juridik, që t'i ofrojë shërbimet për ndihmë juridike falas", ka thënë ministri

Selimi. Pjesë e këtij takimi ishte drejtoresha e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, Anita Alaj-Kalanderi, aktorë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë, përfaqësues të organizatave GIZ dhe USAID dhe nga shoqëria civile.

Në Klinikën Infektive janë të shtrirë 111 pacientë me Covid-19

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës aktualisht janë të shtrirë 111 raste me Covid-19. Në raportimin ditor të kësaj klinike thuhet se 66 raste janë duke u trajtuar në reparte me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive.

"Në repartin e Mjekimit Intensiv të kësaj klinike janë duke u trajtuar 6 raste, 2 raste janë në gjendje të rëndë duke u trajtuar me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive, si dhe 4 raste janë në gjendje kritike me frymëmarrje të asistuar me respiratorë", thuhet në njoftimin për

medie. Po ashtu, bëhet me dije se disa pacientë me Covid-19 janë të shtrirë edhe në objektin e Mjekësisë Sportive dhe në Klinikën e Pulmologjisë. Kosova ka të konfirmuara gjithsej 2 799 raste me Covid-19, prej tyre 1 506 janë shëruar, ndërsa 50 kanë vdekur.



Kërkohet nga qeveria që qytetarëve t'u ofrohen maska pa pagesë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar pas deklaratave të fundit të ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, i cili ka paralajmëruar se do ta përdorin forcën e ligjit ndaj atyre që nuk i respektojnë masat mbrojtëse ndaj koronavirusit, e sidomos ndaj atyre që nuk vendosin maska mbrojtëse. "Kryeministri Hoti dhe ministri Zemaj nuk kanë përgjegjësi për rritjen e numrit të të infektuarve me Covid-19, por nuk e kanë detyrim dhe përgjegjësi që qytetarët, sidomos ata që mundësitë materiale i kanë të vogla, të furnizohen me mjete mbrojtëse pa pagesë aq më parë që ka pasur shumë donacione ndërkombëtare për këtë. Të rrallë janë ata që kanë mundësi që për një maskë mbrojtëse për një përdorim të paguajnë nga 1 euro për vete dhe nga 1 euro për çdo anëtar të familjes. Në vend të kërcënimit duhet të krijohet një mundësi që qytetarët të furnizohen me masa mbrojtëse pa pagesë", bëhet me dije në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se në Kosovë nuk është shpallur gjendje e jashtëzakonshme për t'u përdorur mjete të jashtëzakonshme juridike që nuk janë të rregulluara me ligj. Ky këshill ka vlerësuar se është rritur numri i të infektuarve për



faktin se është rritur numri i testeve për Covid-19. KMDLNj-ja u ka bërë thirrje qytetarëve që t'u përmbahen rekomandimeve të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e situatës dhe ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës të përkrahët me shumë sistemi shëndetësor mbi të cilin po bie barra kryesore në luftimin e pandemisë.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se inspektorët sanitarë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK) dhe inspektorët komunalë do të veprojnë me forcën e ligjit kundër atyre që nuk respektojnë masat parandaluese dhe

rregullat kundër Covid-19. "Rekomandimet parandaluese për Covid-19 të IKShPK-së përfshijnë 22 masa të veçanta që patjetër duhet të respektohen. Pikërisht kryesore është se bartja e maskave të jetë obliguese. Masa të tjera të veçanta që parashihen janë edhe: distanca fizike, dezinfektimi, ajrosja e lokaleve, higjiena, dhe masa të tjera të punonjësit, zyrtarët, institucionet dhe bizneset", ka thënë Zemaj. Ai ka shtuar se inspektorët përkatës në terren çdo ditë do ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe do të merren masa përgjegjëse në rast të moszbatimit eventual të

rekomandimeve të Institutit Kombëtar. "Çdo shkelje e rregullave nga kushdo qoftë, që do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së tjerëve, do të marrë përgjigjen ligjore", është shprehur Zemaj. Edhe kryeministri Avdullah Hoti të hënën, pas një takimi të komitetit për koordinimin e vlerësimit të situatës dhe pandemisë Covid-19, ka thënë se çdokush që nuk respekton masat paraqet vepër penale. Por, juristë në Kosovë nuk e shohin vepër penale mosrespektimin e masave pasi, sipas tyre, për një çështje të tillë duhet të ketë ligj të veçantë për pandeminë Covid-19. Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi, ka thënë

për "Radion Evropa e Lirë" se në bazë të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, vepër penale është vetëm për ata persona që e dinë se janë infektuar përmes testimit dhe nuk marrin masa për mospërhapjen e sëmundjes. "Në këtë drejtim të gjitha thirrjet e Ministrisë së Shëndetësisë, zyrtarëve të qeverisë, se do të ketë pasoja juridike për personat që nuk zbatojnë këto masa, më shumë janë retorikë sesa që mund të prodhojnë efekte juridike. E vetmja mënyrë që shteti t'i përdorë mekanizmat që ka në dispozicion, për t'i ndëshkuar qytetarët të cilët nuk respektojnë masat, është miratimi i ligjit", ka deklaruar Miftaraj.

Ai ka kujtuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese në muajin mars kur është shpallur jokushtetues një vendim i Ministrisë së Shëndetësisë, duke konstatuar se "kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore mund të bëhet "vetëm me ligj" të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës".

Edhe Avokati i Popullit të Kosovës, Hilmi Jashari, ka thënë se nuk ka bazë ligjore për ndëshkimin e personave të cilët nuk zbatojnë masat parandaluese dhe rregullat kundër Covid-19. Në një përgjigje për REL, Jashari ka thënë se lidhur me ndëshkimet bazë juridike duhen konsideruar dy aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese.

Njësia K9 e Policisë së Kosovës pranon pesë qen për të zbuluar armë të teknologjisë së re

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ia ka dorëzuar të martën pesë qen Njesisë K9 të Policisë së Kosovës (PK), në një ceremoni në të cilën ishin të pranishëm ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së, Maria Suokko, ambasadori i Gjermanisë, Christian Heldt dhe zyrtarë të tjerë të institucioneve të Kosovës dhe ndërkombëtare. Përderisa qentë e K9 të Policisë së Kosovës janë të trajnuar për zbulimin e barotit ose armëve të kontaminuara, teknologjitë e reja, duke përdorur materiale jotradicionale siç janë polimeret, po përdoren gjithnjë e më shumë për prodhimin e armëve të vogla. Përmes projektit Ndhimë për

Luftimin e Trafikimit të Armëve të Paligjshme (CIAT) në Kosovë, të financuar bujarisht nga qeveria gjermane, pesë qen K9 janë prokuruar për Policinë e Kosovës që do të trajnohen nga instruktorët e certifikuar të K9 të PK-së për nuhatjen e polimerit.

Qentë do të jenë një shtesë e shkëlqyeshme për Njësinë K9 pasi që do t'i ndihmojë agjencisë në zbatimin e ligjit për identifikimin efektiv të armëve të paligjshme të trafikuar, veçanërisht ato nga polimeri.

Në këtë ngjarje drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj dhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së, Maria Suokko, nënshkruan dokumentet e dorëzimit dhe për pjesëmarrësit u bë një prezantim i shkurtër i "qenve në veprim" për t'i treguar aftësitë e shtesave të fundit të Njesisë K9.



OAK-u kërkon përkrahje nga partitë politike në Kuvend për tejkalimin e krizës

Prishtinë, 30 qershor (ER) - Mundësitë për përkrahje lidhur me problemet e bizneseve, finalizimi i pakos dhe rimëkëmbjes, ofrimi i përkrahjes në ndryshim-plotësimin e ligjeve të cilat janë aktualisht në proces, krijimi i ofertave për investitorët, krijimi i arkës "patriot", ofertat strategjike në bujqësi, mbrojtja dhe orientimi i bizneseve, Ligji për Investime Strategjike, iniciimi i sigurimeve shëndetësore dhe sigurimit në punë ishin disa nga çështjet që u ngritën në takimin e përfaqësuesve të Oda e Afarizmit të Kosovës me liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

Në kuadër të takimeve që OAK-u është duke realizuar me kryetarët e partive politike, në takimin me Kurtin u theksua rëndësia e bashkëpunimit reciprok për përkrahje dhe

tejkallim të gjendjes së rëndë me të cilën janë duke u ballafaquar bizneset si rezultat i pandemisë. Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e OAK-ut kanë theksuar emergjencën e finalizimit sa më parë të pakos së rimëkëmbjes në mënyrë që bizneset të kenë mundësi që të mbijetojnë, mbajnë në punë punëtorët dhe sigurimin e kapitalit për ruajtje të likuiditetit. "Theks i veçantë iu kushtua rëndësisë së finalizimit sa më parë të Ligjit të Punës dhe Pushimit të Lehonisë duke u cilësuar dy nga ligjet esenciale të zhvillimit të vendit si rezultat i të cilëve kemi një numër shumë të ulët të të punësuarve, largimin e fuqisë punëtore në vendet e BE-së për një jetë dhe mirëqenie më të mirë. Gjithashtu, Ligji për Tregti të Brendshme është më se i nevojshëm duke rregulluar tregun në bazë të nevojave dhe



analizave, njëkohësisht duke mbrojtur dhe orientuar bizneset, u tha nga përfaqësuesit e OAK-së", theksohet në njoftimin e kësaj ode.

Hamdi Malushaj, anëtar i bordit në OAK, ka theksuar rëndësinë e aftësisë profesionale, respektimin e kontratave të punës, afatet e paralajmërimeve

dhe rëndësinë e ndarjes së qartë të të drejtave dhe detyrimeve mes punëtorëve dhe punëdhënësve.

Malushaj, gjithashtu, veçoi qasjen e shtetit ndaj biznesit dhe trajtimin që bizneset janë duke marrë aktualisht nga shteti duke lënë shumë hapësirë për të dëshiruar.

Anëtar i bordit të OAK-ut, Hysni Zogaj, ka vlerësuar rëndësinë e ofrimit të përkrahjes për sektorin e bujqësisë dhe minierave e mineraleve duke qenë dy ndër sektorët më me potencial të zhvillimit të vendit.

Ndërsa sekretari i bordit, Diamant Elshani, ka veçuar rëndësinë e unitetit më të madh dhe bashkëpunimin me komunitetin e biznesit qysh në fazat e hershme të iniciimit të nismave ligjore, në mënyrë që së bashku me institucionet dhe bizneset të diskutohen në grupe punuese çështjet me interes reciprok.

Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka falënderuar përfaqësuesit e OAK-ut për takimin dhe çështjet që u ngritën, duke u shprehur i hapur për bashkëpunim në ndryshimin e praktikave dhe qasjes ndaj bizneseve.

Ujësjiellësi 'Prishtina': Shpenzojeni racionalisht ujin e pijshëm

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Prishtina" u ka bërë thirrje qytetarëve që furnizohen nga kjo kompani, që ujin ta shpenzojnë racionalisht. "Sot në botë konstatohet se gjysma e gjithë njerëzve të planetit ballafaqohen me mungesën e ujit të pijshëm.

Roli i ujit është thelbësor për qeniet e gjalla dhe planetin. Ai na nevojitet për pije e higjienë, por me rëndësi është ta kuptojmë domethënien e përdorimit jo të drejtpërdrejtë të ujit si për prodhim, furnizim dhe zhvillim. Hapat që ndërmarrim sot janë të një rëndësie jetike për ne dhe

fëmijët tanë. Uji sot nuk duhet të shfrytëzohet në mënyrë të pakontrolluar, me ç'rast i zvogëlojmë rezervat e ujit të pijshëm, por uji duhet kursyer pikë për pikë. Vetëm kështu sigurojmë sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm për të ardhmen", është thënë në njoftimin e

Ujësjiellësit "Prishtina".

Kjo kompani ka njoftuar se sot kemi rritje enorme të kërkesave për ujë të pijshëm, pavarësisht që shpërndarja po bëhet në mënyrë të barabartë dhe me kapacitete maksimale trajtuese. "Që uji të arrijë edhe në pikat e larta, lusim konsumatorët që

jetojnë në pika të ulëta të mos e keqpërdorin. Nga ju kërkojmë shpenzim racional të ujit, ndërsa ne jemi duke inspektuar terrenin për kyçje ilegale dhe keqpërdorime të ujit, me theks të veçantë nëpër fshatra", theksohet në këtë njoftim të Ujësjiellësit "Prishtina".



Reçica dhe ambasadori austriak flasin për mundësinë e arritjes së marrëveshjes për sigurimet sociale

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger, me të cilin ka diskutuar lidhur me angazhimet e Qeverisë së

Kosovës rreth menaxhimit sa më të mirë të situatës pandemike. Reçica, gjithashtu, e ka njoftuar ambasadorin austriak edhe për prioritetet e MPMS-së në funksion të reformave. Po ashtu, ministri i MPMS-së, Skender Reçica, e ka falënderuar ambasadorin

austriak për gjithë angazhimin e shtetit austriak që ndër vite ka dhënë për Kosovën si dhe ka shprehur gatishmërinë tij për të punuar edhe më shumë në funksion të arritjes së marrëveshjes për sigurimet sociale në mes të Kosovës dhe Austrisë.



Qeveria ta konsiderojë me prioritet Projektligjin për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka vlerësuar se krijimi i një mjedisi të favorshëm, i cili do ta garantonte besueshmërinë e transaksioneve elektronike, shërben si parakusht për zhvillimin e ekonomisë digjitale. "Ligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike, përveç se do t'i kontribuonte zhvillimit të ekonomisë digjitale, do ta zvogëlonte barrën administrative për transaksione elektronike me palë, do ta rriste efikasitetin e proceseve të biznesit duke reduktuar në mënyrë të ndjeshme kostot, ndërsa bashkë me rritjen e sigurisë në transaksionet elektronike do t'u ofronte bizneseve një bazë më të madhe të konsumatorëve", është thënë në komunikatën e OEAK-ut. Në këtë aspekt, thuhet se Komiteti i Ekonomisë Digjitale i Odës

Ekonomike Amerikane në Kosovë ka argumentuar përgjatë viteve të shkuara nevojën e hartimit të kornizës së duhur ligjore.

Qeveria e Kosovës ka aprovuar në korrik të vitit 2019 Projektligjin për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike megjithatë, për shkak të zhvillimeve politike, projektligji nuk ka mundur të procedohet në Kuvend dhe ta marrë aprovimin e deputetëve. "Kufizimi i aktiviteteve dhe shmangia e kontakteve fizike pas shpërthimit të pandemisë Covid-19 ka nxitur bizneset që t'i transformojnë operacionet e tyre duke shfrytëzuar përparësitë e teknologjisë digjitale, megjithatë bizneset e Kosovës janë të kufizuara në këtë aspekt për shkak të mungesës së një legjislacioni që do ta lejonte realizimin e transaksioneve elektronike, përfshirë këtu edhe pagesën e tyre, por edhe çfarë është më e rëndësishmja, njohjen nga ana e institucioneve tatimore në



vend. Për rikujtim, edhe Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës, si dhe shumë organe të tjera qeverisëse të nivelit qendror dhe komunal, gjenerojnë dokumente elektronike dhe funksionojnë sipas sistemit pa

letër", theksohet në këtë komunikatë.

Në këtë aspekt, marrë parasysh rëndësinë dhe nevojën e këtij ligji për operimet dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të të gjitha ndërmarrjeve në vend, me theks të veçantë të atyre nga sektori i

teknologjisë së informacionit, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i ka kërkuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, që ta konsiderojnë me prioritet aprovimin e këtij projektligji.

Nënshkruhet marrëveshja 1 milion e 500 mijë euro për t'i ndihmuar bizneset

Prishtinë, 30 qershor (ER) - Në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Burim Rreci, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Durim Hoxha, menaxher i projektit nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). Kjo marrëveshje do t'i shërbejë sektorit privat me qëllim të krijimit të intervenimeve lehtësuese, të cilat do të zhvillojnë edhe më tutje sektorin privat dhe ta ngrehin vetëdijen ndërmarrëse në Kosovë.

Vlera e projektit është 1 milion e 500 mijë euro, ndërsa Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, bashkë me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, do të ndihmojnë me 300 mijë euro. Nga ky projekt pritet të nxirren rezultate në mjete dhe shërbime të reja digjitale relevante që do të jenë në dispozicion dhe të përdoren nga Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme të Kosovës (NMVM); NVM-të e Kosovës ta përmirësojnë nivelin e tyre të digjitalizimit dhe krijojnë lidhje tregu dhe konsulentët e bizneseve të ofrojnë shërbime të

digjitalizimit, të cilat janë efektive dhe të përballeshme për NVM-të.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka thënë se është jashtëzakonisht i kënaqur me bashkëpunimin e Kosovës me Austrinë dhe ka vlerësuar lart rolin e këtij shteti në mbështetje të bizneseve të Kosovës, ndërsa sekretari Burim Rreci ka deklaruar se e kanë mbështetjen e ministrit Krasniqi për t'i çuar përpara proceset dhe nismat që mbështesin bizneset e Kosovës. Ndërkaq shefi i zyrës së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) në Kosovë, Gunther Zimmer, ka thënë se Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) përmes projektit ACCESS vazhdon përkrahjen për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve private dhe luftimit të varfërisë. Sipas Zimmer, ky projekt do të ketë impakt në zhvillimin rural, arsimin e lartë, stimulimin e investimeve të huaja dhe fuqizimin e sektorit privat. Projekti do t'i rrisë rezultatet e të



ardhurave më të larta dhe mundësitë e punësimit në sisteme më të qëndrueshme të tregut. Po ashtu, ky projekt do të

kontribuojë në fuqizimin e kompanive të sektorit privat dhe në rritjen e të ardhurave të

tyre përmes qasjes së qëndrueshme në treg dhe lidhjeve më të fuqishme rajonale dhe ndërkufitare.

Përurohët atraksioni turistik “Auto-Kampi” në Prizren

PRIZREN, 30 QERSHOR (ER) - Komuna e Prizrenit, pas realizimit të projekteve të ndryshme për pasurimin e ofertave turistike në Prizren, si kajaku, çiklizmi malor, paragllajdi, via-ferrata, shtigjet e ecjeve dhe vende për piknik, ka bërë lansimin e

projektit të ri për “Auto-Kamp”, i pari i llojit të tillë në Kosovë. Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, gjatë lansimit ka njoftuar se në kuadër të këtij projekti janë krijuar hapësira për dhjetë vetura për kamping, hapësira gjelbëruese,

ulëse për pushim, pajisje sportive dhe lodra për fëmijë. “Në këtë vend tanimë turistët vendorë dhe ndërkombëtarë mund furnizohen edhe me rrymë dhe nevoja të tjera që i duhen një vendkampingu të tillë. Kjo është vetëm faza e parë

e këtij projekti, ku investimet do të vazhdojnë edhe më tej me kyçjen e ujit, vendosjen e dushkabinave, si dhe do të bëhet qasja në rrugën kryesore”, ka shprehur Haskuka, i cili e ka falënderuar Shoqatën e Beshkatarëve Sh. B. “Sharri” për

gatishmërinë e treguar për mirëmbajtjen e kësaj hapësire që ndodhet vetëm një kilometër larg nga qendra e qytetit, ndërkaq i ka ftuar të gjithë qytetarët që ta shfrytëzojnë dhe ta mbrojnë këtë ambient si pasuri e të gjithë qytetarëve.



Begaj emëron katër drejtorë të rinj në Malishevë



MALISHEVË, 30 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka prezantuar të martën katër drejtorë të rinj të drejtorive komunale, të cilëve edhe ua ka dhënë vendimet për emërim në detyrat e tyre. Drejtorët e rinj të cilët kanë marrë detyrat janë: Besartë Kryeziu-Ramaj është emëruar drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme,

Rexhep Mazreku drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Ahmet Morina drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit dhe Hafir Rexha, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Në ceremoninë e dhënies së detyrave për drejtorit e rinj, kryetari Begaj ka kërkuar angazhim dhe bashkëpunim të mirë, me qëllim të realizimit të detyrave që i presin. “Kërkoj bashkëpunim dhe angazhim nga

ana juaj. Kemi obligime në raport me qytetarët, prandaj kërkoj shumë punë dhe shumë angazhim, që së bashku t’ia dalim realizimit të detyrave dhe obligimeve që kemi. Ju uroj punë të mbarë dhe suksese në drejtoritë që do të drejtoni”, ka thënë Begaj. Begaj i ka falënderuar edhe ish-drejtorët e deritanishëm për punën dhe kontributin e tyre në drejtimin e drejtorive komunale.

Kryetari i Pejës kërkon që të vazhdohen procedurat e prokurimit për të gjitha projektet për këtë vit

PEJË, 30 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka mbajtur takim konsultativ të Këshillit të Drejtorëve, i cili fillimisht ka prezantuar një elaborat të shkurtër për punët në përgjithësi në komunë. Muahxheri ka kërkuar nga drejtorët dhe Zyra e Prokurimit që të vazhdojnë procedurat e

prokurimit për të gjitha projektet që janë të parapara për këtë vit, me qëllim që ato të kryhen sipas planifikimit dhe në kohë optimale. Drejtori i Arsimit, Besim Avdimetaj, ka njoftuar se zyrtarisht ka përfunduar viti shkollor, përveç testit të maturës dhe testit të arritshmerisë që është vendosur të mbahen në muajin

gusht. Drejtori i Bujqësisë, Mehdi Mulaj, ka pohuar se u duhen hapësira të mjaftueshme bazuar në rregulloren për Covid-19 në kohën kur do të bëhet pranimi i kërkesave për subvencione, pasi të shpallen nga Ministria e Bujqësisë. Takimi i radhës i Këshillit të Drejtorëve do të mbahet sipas nevojës dhe situatës.



NDRYSHIMET E KUFIJVE TË KOSOVËS 1945-1959



Shkruan:
Mentor TAHIRI

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kur edhe de facto formohet Federata e dikurshme e Jugosllavisë (filimisht RPFJ, më pas RSFJ), kanë ndodhur eksperimente territoriale dhe ndryshime të shumta të kufijve administrativë gati në të gjitha pjesët e Federatës. Është ndryshuar edhe vetë struktura e hierarkisë së njësive të pushtetit lokal. Këto ndryshime kanë ndodhur me akte ligjore në nivel federativ dhe republikan në vitet 1945, 1947, 1949, 1952, 1955, 1959. Ndryshimet territoriale-administrative kanë afektuar edhe vetë kufijtë ndërmjet njësive federale (diku edhe me marrëveshje për ndërrimin e territorit), kurse në pozitën më të vështirë në këtë konstalacion ka qenë Kosova.

Statusi i brishtë i Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, pothuajse ekzistent vetëm në letër, nuk ka precizuar kufijtë në nivel të Kosovës por, thjesht, ky territor është nënkuptuar me kufijtë e rretheve (qarqeve). Kosova do ta ketë territorin e vet të precizuar qartë vetëm pas vitit 1963, kur edhe ngritët në statusin e Krahinës Autonome (sipas kufijve të rretheve në vitin 1959), një proces ky gradual i rritjes së shkallës së autonomisë i cili merr formë më të plotë në vitin 1974 me ndryshimet kushtetuese të

atëhershme.

Sidoqoftë, pavarësisht prej ndryshimeve të shpeshta në ligjet që kanë afektuar ndarjen territoriale-administrative, jo të gjitha ndryshimet ishin të specifikuar në ligj. Kosova në këtë drejtim, deri në konsolidimin e tërësisë territoriale në vitin 1963 (sipas ligjit të vitit 1959), do të tkurret në disa pjesë kufitare. Bëhet fjalë për tre terri-tore: 1. Terrenin malor dhe kullosat ngjitur me Rugovën, në opinion tanë e njohur si "Çështja e demarkacionit me Malin e zi"; 2. Territori në jug të Komunës së sotme kadastrale të Restelicës në Komunën e Dragashit; 3. Territori pranë pikës së sotme kufitare me Serbinë në Mutivodë.

Ndryshimet e tilla janë legalizuar gati në heshtje dhe kanë marrë "zyrtarizimin" vetëm përmes ndonjë dokumenti i cili në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ka pasur të bëjë me çështje të rregullimit territorial-administrativ, si p.sh me botimet me të dhëna nga Regjistrimi i Popullsisë. Këto ndryshime megjithatë janë "betonuar" me ligjin e vitit 1959, i cili ka përcjellë gjendjen faktike të kontrollit në terren. Mbi këtë gjendje më pas janë konsoliduar elemente që shpijnë deri tek mendimet e Komisionit të Badinterit lidhur me përcaktimin e kufijve të shteteve që kanë lindur pas procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë. Në rastin e "Çështjes së demarkacionit me Malin e zi", pretendimet se kufiri duhet matur me hartën e vitit 1945, pësuan fatin e pretendimeve të ngjashme në pjesë të tjera të ish-Federatës.

Humbja e parë e madhe pa mbështetje në ndonjë akt ligjor,

që ka pësuar Kosova kur bëhet fjalë për këto ndryshime të heshtura territoriale, është ajo 8.885 hektarëve, në jug të fshatit Restelicë. Ky territor, kryesisht i përbërë nga kullosat, në vitin 1945 i ishte lënë në shfrytëzim ndërmarrjeve të atëhershme shoqërore të Maqedonisë. Qysh në vitin 1948, pa një dokument të shkruar por thjeshtë me masa policore, blegtorëve nga Kosova u ndalohet qasja në këto kullosa. Ka një dokument të shkruar të datës 19 Nëntor 1948 kur lidhur me çështjet e këtij territori, autoritetet e atëhershme në Prishtinë ankohen tek autoritetet në Beograd.

Megjithatë, 8 885 hektarë më asnjëherë nuk do t'i kthehen Kosovës, respektivisht Rrethit të atëhershëm të Prizrenit, të cilit i përkisnin. Sot ky territor përbën një pjesë të territorit të Zonës Kadastrale të Vaut (Brodecit) në Komunën e Gostivarit. Përndryshe, në shkëmbimet e vitit 1948, autoritetet në Prishtinë ngrisin edhe çështjen e kufirit në drejtim të Popova Shapkës.

Kur bëhet fjalë për ndryshimet territoriale me anë të ligjeve, janë dy ligje që kanë efekt në ndryshimet e kufijve të Kosovës, ai i vitit 1947 dhe ai i vitit 1959.

"Ligji mbi ndarjen administrative" i datës 18 Prill 1947 (Gazeta Zyrtare e RPS-së 17/1947), merr nga Rrethi i Gjilanit dhe ia bashkëngjitet Rrethit të Bujanocit një serë fshatrash: Kijevë, Depcë, Sefer, Stanec, Caravajkë, Peçen, Maxherë dhe Ranatoc. Me të njëjtin ligj, me qëllim të eliminimit të shumicës shqiptare në Rrethin e Shkupit, Kaçaniku i bashkëngjitet Rrethit të Prishtinës. Me të njëjtin qëllim, dobësimin e shumicës etnike

shqiptare në Rrethin e Kumanovës, Presheva i bashkëngjitet Rrethit të Bujanocit. Ndryshimet territoriale të vitit 1947 i japin formë Komunës së sotme të Preshevës, por në aspektin strategjik dobësojnë praninë shqiptare në Maqedoni dhe me anë të këtyre ndryshimeve realizohet një inxhiniering etnik në Rrethet e Shkupit dhe të Kumanovës, duke i hequr strukturës së popullsisë së këtyre rretheve një pjesë të madhe të popullsisë shqiptare. "Ligji mbi territoret e komunave dhe rretheve" i datës 12 Dhjetor 1959 (Gazeta Zyrtare e RPS-së 51/59) do të ketë efekt në ndryshimin e kufirit në cepin verior të Kosovës. Me anë të këtij ligji, i hiqen Rrethit të Rashkës dhe i bashkëngjiten Rrethit të Zveçanit (Mitrovicës) këto fshatra: Beluçe, Berberishtë, Bistricë, Bare, Belo Bërdë, Borovë, Vraçevç, Guvnishtë, Krnjn, Zemanicë, Ishevë, Leshak, Miokoviç, Ostrac, Potkomnje, Rvatskë, Trebiçe, Çirkoviç, Crnatovë dhe Postenjë.

Territori i këtyre fshatrave është 197 m², respektivisht 36.5% e territorit të sotëm të Komunës së Leposaviqit. Në opinion shpesh bëhet fjalë se si Kosovës i është dhënë falë Leposaviqi. Megjithatë, përveç disa teksteve me burime të pa verifikuara, nuk ka asnjë dokumentacion zyrtar i cili dëshmon se pjesa më e madhe e Komunës së Leposaviqit ka qenë jashtë Rrethit të Zveçanit (Mitrovicës), së paku që nga rithemelimi i këtij Rrethi pas luftës së dytë botërore. Ndarja e dikurshme administrative në segmentin Leshak-Leposaviq korrespondon me kufirin e

dikurshëm Osmano-serb deri në vitin 1912, si dhe pikëkalimin kufitar i cili gjendej në fshatin Dren.

Komuna e sotme e Leposaviqit në territorin aktual themelohet me "Ligjin mbi territoret e komunave dhe rretheve" të datës 12 dhjetor 1959, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi me 1 Janar 1960. Me këtë ligj, hiqen rrethet si njësi administrative, konfirmohen disa Komuna ekzistuese, kurse shumica e Komunave humbin statusin.

Sipas ligjit të ri të vitit 1959, nga dikur 65 komuna, territori i Kosovës (atëherë Rajoni Autonom i Kosovës-Metohisë) përbëhej nga 28 komuna, e të cilat, sipas emrave zyrtarë të kohës ishin: Vitia, Vuçitërna, Gllgovci, Gjilani, Deçani, Gjakova, Gjilani, Dragashi, Zubin-Potoku, Istogu, Zymi, Kaçaniku, Klina, Kamenica e Kosovës, Mitrovica e Kosovës (më vonë Mitrovica e Titos). Leposaviqi, Lipjani, Malisheva, Novo Bërda, Orllani, Rahoveci, Peja, Prizreni, Prishtina, Srbica, Suha Reka, Ferizaj dhe Shtërpca.

Pas vitit 1959 më nuk do të ketë ndryshime territoriale të Kosovës. Ndryshimet e vetme do të jenë ato të rregullimit të brendshëm territorial-administrativ. Në vitin 1966, do të shuhet gjashtë komuna të cilat ekzistonin sipas ligjit të vitit 1959. Do të shuhet Zubin-Potoku, Zymi, Malisheva, Novo Bërda, Orllani dhe Shtërpca. Pas kësaj Kosova do të ketë 22 komuna. Ky numër i komunave do të qëndrojë deri në vitet 80-të, kur për arsye politike kryesisht etnike do të formohen komuna të reja, sikurse ato në periferi të Prishtinës dhe të Mitrovicës.

Podujeva do të bëhet me spital të përgjithshëm

PODUJEVË, 30 QERSHOR (ER) - Komuna e Podujevës ka dhënë në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme për ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm të Podujevës për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Kontrata është nënshkruar të martën nga drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Basri Sejdiu dhe kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari. Në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshje ishte i pranishëm edhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës që vijnë nga Komuna e

Podujevës.

Parashihet që ShSKUK-ja ta hartojë projektin zbatues dhe ta ndërtojë objektin e ri të Spitalit të Përgjithshëm në Komunën e Podujevës si dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e tij.

Pas funksionalizimit, i njëjti organizohet, mirëmbahet, menaxhohet dhe administrohet nga ShSKUK konform legjislacionit përkatës në fuqi.

Të pranishmit në këtë aktivitet e vlerësuan të domosdoshëm dhe shumë të rëndësishëm ndërtimin e këtij spitali në mënyrë që banorët e Podujevës të kenë qasje në shërbimet shëndetësore.



Venezuela dëbon ambasadorin e BE-së

KARAKAS, 30 QERSHOR - Presidenti i Venezuelës, Nicolas Maduro, urdhëroi ambasadorin e Bashkimit Evropian në këtë vend që të largohet brenda 72 orësh.

Dëbimi i Isabel Brilhante Pedrosas erdhi disa orë pasi BE-ja vendosi sanksione

kundër 11 zyrtarëve të Venezuelës. Ata u sanksionuan për veprime kundër Asamblesë kombëtare, të kryesuar nga udhëheqësi i opozitës, Juan Guaido.

Guaido e ka shpallur veten president të përkohshëm vitin e kaluar, por ai nuk ka arritur ta

largojë Maduron nga pushteti. Lideri i opozitës ka mbështetur e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara. "Nëse ata nuk mund ta respektojnë Venezuelën, atëherë duhet të largohen", tha Maduro duke folur për zyrtarët e BE-së. Të hënën, Këshilli Evropian tha

se 11 zyrtarë të Venezuelës janë shtuar në listën e të sanksionuarve "për shkak të rolit të tyre në akte dhe vendime që dëmtojnë demokracinë dhe shtetin e ligjit në Venezuelë". Në total janë 36 zyrtarë të Venezuelës të sanksionuar nga BE-ja.



Merkeli dhe Macroni bëjnë thirrje për plan të rimëkëmbjes së BE-së nga koronavirusi

BERLIN, 30 QERSHOR - Presidenti francez Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane Angela Merkel kanë bërë thirrje për fond "të fuqishëm" të rimëkëmbjes nga koronavirusi për Bashkimin Evropian. Merkeli ka mirëpritur në Berlin presidentin Macron, teksa Gjermania përgatitet për ta marrë presidencën e Këshillit Evropian nga 1 korriku. Të dy liderët kanë propozuar muajin e kaluar krijimin e një plani në vlerë të 500 milionë eurove për t'i ndihmuar Evropës për përballimin e dëmeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit.

Propozimi i përbashkët ishte plotësuar nga Komisioni Evropian, i cili ka çuar përpara planet për një fond prej 750 milionë eurove, të formuar kryesisht prej granteve. Mirëpo jetësimi i tij po përballet me kundërshtimet e disa shteteve

që janë duke hezituar në ndarjen e fondeve.

Tëksa kanë folur në një konferencë për media me Macronin, Merkeli ka thënë se "Gjermania dhe Franca dëshirojnë të luajnë rol të përbashkët në muajin e ardhshëm, që bën të qartë se Evropa është e ardhmja jonë".

"Pritshmëritë janë të larta dhe ne e dimë që kur Gjermania dhe Franca janë të bashkuara, Evropa nuk është e bashkuar domdoshmërisht. Mirëpo nëse Gjermania dhe Franca nuk arrijnë pajtueshmëri, atëherë gjërat nuk janë në rrugë të mirë për unitetin e Evropës", ka shtuar ajo.

Presidenti francez e ka konsideruar pandeminë me koronavirus dhe pasojat shoqërore-ekonomike si "moment të së vërtetës" për Evropën. "Ne mund ta bëjmë këtë moment të së vërtetës në moment të suksesit", ka thënë Macron, duke insistuar në nevojën e arritjes së



marrëveshjes brenda BE-së për planin e rimëkëmbjes ekonomike. "Ne do të bëjmë

gjithçka me kancelaren që të kemi marrëveshje për buxhet në muajin korrik", ka thënë ai.

Kjo çështje do të jetë në agjendën e Samitit Evropian në Bruksel muajin e ardhshëm.

UNHCR i kërkon Hungarisë t'i shfuqizojë disa rregulla të azilit

GIJENEVË, 30 QERSHOR - Agjencia për Refugjatë e Kombeve të Bashkuara (UNHCR) i ka bërë thirrje Qeverisë së kryeministrit të Hungarisë, Viktor Orban, që t'i shfuqizojë disa rregulla të sistemit të azilit, duke thënë se disa dispozita të tyre mund t'i shkelin ligjet ndërkombëtare.

Një zëdhënës i qeverisë hungareze nuk pranoi të komentonte menjëherë.

Muajin e kaluar Hungaria ka mbyllur të ashtuquajturat zona transiti të migrantëve në kufijtë e saj, ka liruar rreth



300 refugjatë që qëndronin atje, por, në të njëjtën kohë,

ka shtrënguar rregullat, duke ua ndaluar hyrjen aplikantëve

të ardhshëm për azil. Rregullat e reja kërkojnë që azilkërkuesit t'i paraqesin aplikacionet e tyre në konsullatat e vendeve fqinje dhe jo në kufirin hungarez. "Kjo mund t'i ekspozojë azilkërkuesit ndaj rrezikut të refuzimit dhe keqtrajtimit, çfarë do të ishte shkelje e Konventës së Refugjatëve të vitit 1951 dhe e instrumenteve të tjera ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, në të cilat Hungaria është palë. Qasja efektive në territor është një parakusht thelbësor

i së drejtës për azil", thuhet në deklaratën e UNHCR-së.

UNHCR-ja i kërkoi Budapestit që të shfuqizojë aktin dhe ta vendosë sistemin e azilit në përputhje me ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe me ligjet e Bashkimit Evropian.

Në kulmin e krizës së migrantëve në Bashkimin Evropian më 2015, Orban, një nga kundërshtarët më të ashpër të imigracionit, ka urdhëruar mbylljen e kufirit jugor të Hungarisë, duke ua bllokuar rrugën qindra mijëra migrantëve.

Presidentin e Polonisë do ta përcaktojë balotazhi

VARSHAVË, 30 QERSHOR - Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të së dielës në Poloni tregojnë se presidenti i vendit, Andrzej Duda, ka dalë i pari, por ai nuk ka siguruar 50

për qind të votave të nevojshme për të udhëhequr. Kjo bën që Duda të përballet në balotazhin e 12 korrikut me rivalin e tij kryesor, kryetarin e Varshavës, Rafal Trzaskowski.

Duda, i cili mbështetet nga Partia në pushtet për Ligj dhe Drejtësi, ka marrë 43.5 për qind të votave, ndërsa Trzaskowski 30.5 për qind.

Trzaskowski vjen nga partia

opozitare, Platforma Civile. Pavarësisht prej pandemisë së koronavirusit, pjesëmarrja në zgjedhje ka qenë 64.4 për qind më e larta që nga zgjedhjet presidenciale të vitit 1995.



KUR INGRID JONKER THËRRISTE: THEY “CAN’T BREATHE”!



Ng: Flutura AÇKA

Ishte 24 maji i vitit 1994, kur në Parlamentin e parë pluralist të Afrikës së Jugut, Nelson Mandela, në mënyrë krejt të beftë dhe emocionuese, e hapi fjalimin e tij me poezinë “Fëmija” të poeteshës afrikane Ingrid Jonker, e cila kishte luftuar gjithë jetën e vet të shkurtër për të drejtat e bashkatdhetarëve të saj me ngjyrë, të vvarë, të dhunuar, të persekutuar nga Aparteidi. Në radhët e persekutorëve të bardhë, ishte edhe babai i saj, Abrahami, si funksionar i lartë i asaj kohe. Ai e shkurratoi vajzën e tij plangprishëse, e cila shkroi këtë poezi të pavdekshme.

Ishte një ditë tragjike, kur Ingridi pa një fëmijë në krahët e nënës, e cila marshonte në mesin e turmës me fëmijën e vdekur në krahë, i vvarë nga një plumb në kokë në protestë në Nianga.

Një nga poeteshat më të rëndësishme të botës, Ingrid Jonker, i dha fund jetës

së vet vetëm pak muaj pas të tridhjetave. Pas një zënke të tillë të ashpër me të atin, e dëshpëruar nga mizoritë që shihte përditë, një shpirt mbiemocional i saj nuk mundi ta përballonte dot: Zbriti një natë korriku mes shkëmbinjve të gjirit të “Tri spirancave” dhe u fut nëpër ujët e errët e të ftohtë të oqeanit. Kur trupin e saj e gjetën të nesërmen tek pluskonte mbi ujë, ndihmësit i raportuan të atit dhe e pyetën se çfarë të bënin me kufomën e së bijës. Ai iu kthye dhe i tha i shkujdesur: “Lëreni atje ku është!”.

Këtë poezi e kam përkthyer herët, dhe duket se nuk do të dalin shpejt nga moda jonë shoqërore lufta ndaj ndarjes në ngjyrë.

Poezia e lexuar nga Nelson Mandela, është një nga gjërat më frymëzuese të ditëve që po kalojmë. Për ta njohur më thellë poeteshën e famshme, më ka ndihmuar mikja ime Petrovna Metelerkamp, njëherësh edhe biografe e Ingrid Jonker-it, të cilën kam patur fat ta takoj në janar 2013 në Kejptaun.

FËMIJA QË U VRA NË NYANGA

Poezi nga: Ingrid JONKER

Fëmija nuk ka vdekur
Grushtin ngre fëmija pranë s’ëmës
Që Afrika! thërret, dhe klith frymën
E lirisë dhe stepave,
Zonave zemërrethuar.

Grushtin ngre fëmija pranë të atit
Paradës së brezave
Që Afrika! thërrasin, dhe klithin frymën
E mundimit dhe gjakut
Udhëve të krenarisë së lënduar.

Fëmija nuk ka vdekur as në Langa as në Nyanga
As në Orlando apo Shaperville
As qendrës policore në Philippi
Ku shtrirë rri prej plumbit që kokën ia ka grirë.

Hija e errët e ushtarëve është fëmija
E gardës me pushkë, autoblinda e shkopinj
Fëmija është i pranishëm në të gjitha takimet ku bëhen ligje
Fëmija përgjon përmes dritareve zemrat e nënave
Fëmija që donte vetëm të luante në rërë në Nyanga, është kudo
Fëmija që u burrërua tani nëpër gjithë Afrikën shtegton

Fëmija që u bë gjigand tani nëpër gjithë botën
pa PASS kalon.

E jashtëzakonshme


Njihuni me gruan me më shumë fëmijë në botë

Mariam Nabatanzi nga Uganda ka lindur dyshen e parë të binjakëve kur ishte vetëm 13-vjeçare, ndërsa pas braktisjes nga burri është detyruar ta rrisë e vetme familjen e madhe. Kur Miriam ishte 36-vjeçare ajo kishte lindur 42 foshnja. Vetëm tani që është 41-vjeçare doktorët i kanë thënë se ka një gjendje të rrallë gjenetike që do të thotë se kryen gjithmonë lindje të shumëfishta, edhe pse kishte kërkuar ndihmë për këtë qëkur ishte 23-vjeçare. Mariami ka lindur tre katërnjakë, katër trinjakë dhe gjashtë çifte binjakësh, ndërsa për të gjithë mrekullisht



kujdeset e vetme. Nëna më pjellore në botë ishte martuar me të shoqin kur ishte vetëm 12-vjeçare, ndërsa ai ishte 40-vjeçar. Pas këtyre lindjeve doktorët e këshilluan se ajo duhet të vazhdonte të lindte pasi i kishte vezoret shumë të pasura. Shtatzënia e fundit e Mariamit tre vjet më parë përfundoi në tragjedi kur lindi çiftin e gjashtë të binjakëve. Një nga foshnjat e saj vdiq gjatë lindjes, ndërsa bashkëshorti që me parë largohej me javë të tëra, tashmë ishte larguar përgjithmonë. Vetëm pas lindjes së fundit doktorët e ndihmuar për të mos lindur më.

FOTO E DITES



Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të hënën është mbajtur ceremonia ushtarake e diplomimit të 15 kadetëve të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve 2016-2020. Pjesë e këtij diplomimi ishte edhe djali i heroit Shkëlzen Haradinaj, Luani.

BARSOLETA E DITËS



Gjykatësi: Nëse dëshironi të mos dënoheni, ktheni paratë që i keni vjedhur.
I akuzuari: Sa dënohem nëse s'i kthej?
Gjykatësi: Pesë vjet burgim.
I padituri: Po të doja t'i ktheja paratë do të kisha hyrë kredi.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

S'mjafton Covid-19, një tjetër virus i rrezikshëm zbulohet në Kinë



Shkencëtarët në Kinë kanë identifikuar një lloj të ri gripi që ka potencialin për t'u bërë një pandemi dhe pse bota ende po përpigjet të mbajë nën kontroll pandeminë aktuale të koronavirusit, shkruan BBC. Ai u shfaq tek derrat, por mund të infekttojë edhe njerëzit. Studiuesit janë të shqetësuar se mund të ndryshojë më tej dhe

mund të përhapet lehtësisht nga një person në tjetrin. Edhe pse ende nuk është një problem, ky "grip i ri" ka të gjitha shenjat e të qenit shumë i përshatshëm për të infektuar njerëzit dhe ka nevojë të shqyrtohet më tepër nga studiuesit. Si diçka e re e pazbuluar më parë, njerëzit mund të kenë pak ose aspak imunitet ndaj virusit.

E rrallë

Zbulohet një re misterioze radioaktiviteti në veri të Evropës

Rritje misterioze e niveleve të radioaktivitetit në Evropën Veriore. Konstatimi është bërë nga autoriteti suedez për sigurinë nga rrezatimi bërthamor që ka pikasur një hapësirë të gjerë që nis nga Rusia dhe prek vendet baltike, jugun e Gadishullit Skandinav deri në ujërat lindore të Britanisë së Madhe, siç duket edhe në këtë hartë. Të njëjtin shtim të

radioaktivitetit kanë konstatuar edhe institute të vendeve të tjera evropiane, të cilat kanë konstatuar shtim të grimcave radionuklide. Niveli nuk është i rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Këto grimca janë pjesë e lëndëve radioaktive që përdoren në centralet bërthamore. Origjina është ende e paqartë. Një pjesë më e madhe e këtij asaj që mund të konsiderohet

si "re bërthamore" shtrihet në lindje të Rusisë, çka ka shtuar dyshimet se ajo mund të jetë përhapur nga ndonjë central bërthamor për prodhimin e energjisë elektrike në këtë vend. Hera e fundit që në Evropë u përhap një re bërthamore ishte në vitin 1986, gjatë katastrofës së Çernobilit në Ukrainë, në atë kohë ish-Bashkimi Sovjetik.



 <p>DASHI Nuk këshillohet ta ndryshoni rrjedhën e zakonshme të jetës dhe të përfshiheni në aventura financiare, ka gjasa të keni rezultate negative.</p>	 <p>DEMI Mos luftoni me fatin. Lëri gjërat të rrjedhin vetë. Përpiquini të çlirohni nga problemet e pazgjidhura. Komunikoni më shumë në familje.</p>	 <p>BINJAKËT Mos bini pre e fiksimeve. Adresoni problemet tuaja, vini rregullat në shtëpi dhe kushtojini vëmendje partnerit/partneres suaj.</p>	 <p>GAFORRJA Keni të gjitha shanset për të kaluar një të diel të shkëlqyer. E vetmja gjë që mund t'ju prishë humorin është mosmbajtja e një premtimi nga ana e shoqes/shokut të ngushtë.</p>	 <p>LUANI Ekziston mundësia që të shuani një konflikt të mundshëm të dikujt pranë jush. Mos harroni planet për fundjavë.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Ndoshta shkak për këtë mund të jetë dikush që ju i besoni shumë. Në mbrëmje do të merrni një sërë lajmesh, por mos i besoni plotësisht nëse nuk ka dëshmi.</p>
 <p>PESHORJA Ndoshta synimi juaj është t'i gjeni shkaqet e disa problemeve. Bisedoni me njerëz me përvojë. Ndoshta një mendje pozitive do të ndihmojë ta zgjidhni këtë situatë.</p>	 <p>AKREPI Do të ndiheni mjaft optimist këtë të martë. Ndoshta një festë në familje apo një banket do t'ju bashkojë me personat më të ngushtë.</p>	 <p>SHIGJETARI Këshillohet të bëni mjaft kujdes me financat, pasi shpenzimet mund ta tejkalojnë buxhetin. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme t'i kushtoni vëmendje të veçantë shtëpisë.</p>	 <p>BRICJAPI Jepuni prioritet aktiviteteve që ju relaksojnë emocionalisht. Do të ishte mirë të bënit një plan për të gjithë verën në vijim.</p>	 <p>UJORI Mos u dëshpëroni nga rrethanat në të cilat ndodhëni. Tregoni se sa shumë besim keni në vetvetë dhe nxirri në pah karakterin tuaj të fortë.</p>	 <p>PESHQIT Nuk përjashtohet mundësia që një person me të cilin keni kujtime mjaft të bukura, të vijë t'ju takojë. Ata që janë në një marrëdhënie, ka gjasa të marrin një dhuratë mjaft të këndshme.</p>

Bebe Rexha në përkrahje të LGBT-së, grimohet me ngjyra të ylberit



Bebe Rexha ka dhënë mbështetje për komunitetin e LGBT-së. Muaji qershor njihet si muaji i krenarisë nga komuniteti i LGBT-së dhe artistë të shumtë kanë dhënë mbështetjen e tyre në forma të ndryshme. Së fundmi edhe këngëtarja shqiptare

Bebe Rexha, e cila jeton në ShBA, ka publikuar një fotografi në "Instagram", ku bën të qartë se qëndron pas kësaj shoqërie. Në fotografinë e ndarë ajo shihet e grimuar me ngjyra të ylberit dhe si mbishkrim ka lënë "Pak me vonesë por, urime muaji i krenarisë".



Për ku është nisur Era Istrefi?



Era Istrefi është shfaqur tepër seksi në disa fotografi të cilat i ka postuar në rrjetet sociale. Këngëtarja ka qenë e qetë gjatë gjithë pandemisë, derisa ishte shfaqur vetëm një herë me disa fotografi që i kishte bërë gjatë ditëlindjes së vajzës së motrës së saj, Nora Istrefit. Por, ajo ka postuar disa


fotografi ku shihet në një avion derisa poshtë tyre ka shkruar: "Po shkoj diku". Këngëtarja pas këngës "Bonbon" nuk ka pasur suksese të mëdha derisa disa këngë të saj kanë pasur sukses të kufizuar dhe jo atë që është pritur në fillimet e këngëtares pasi ka nënshkruar kontratën me "Sony Entertainment".

Arta tregon pak nga gjoksi

Modeluesja dhe aktorja Arta Elezaj ka vazhduar publikimin e fotografive seksi. Bukuroshja nga Kosova kishte "vuajtur" gjatë vetizolimit në Kosovë, ku edhe pak kishte publikuar fotografi. Por, tani ajo nuk ka të ndalur. Prej lehtësim-

it të masave Arta ka vazhduar me fotosesione të ndryshme, derisa duket se edhe ka hequr disa kilogramë gjatë vetizolimit. Bukuroshja duket në formë të mirë dhe seksi në fotografitë e fundit të publikuara në rrjetet sociale.

Modeluesja e 'Victoria Secret' tërheq vëmendjen me pozat në bikini



Ajo ka bërë me dije se ka shtuar pak kile gjatë izolimit. Sara Sampaio ka treguar se humori i saj është më lart se kurrë, në fotografitë e publikuara në rrjetet sociale. 28-vjeçarja e "Victoria Secret" ka pozuar pa grim para diellit, ndërsa ishte duke shijuar ditën e përkryer në një plazh. "Pamë një muzg të bukur dje" ka shkruar Sara në llogarinë e vet në "Instagram".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ymeri: Drenica e ka vendin në Superligë

Arion Ymeri ka thënë të martën për "Epokën e re" se Drenica ka skuadër cilësore dhe kjo do t'i mundësojë pa problem për mbetjen në IPKO Superligë. "Rreziku ekziston, por e mira është se ende kemi katër pikë para zonit të rrezikshëm dhe, pavarësisht prej kundërshtarëve që i kemi, ne duhet t'u qasemi lojërave një nga një dhe të fitojmë sa më shumë pikë kur kanë mbetur edhe gjashtë lojë. Besoj fuqishëm në bashkëlojtarët e mi sepse të gjithë kanë cilësi dhe ky ekip, me kualitetin që ka, normalisht se nuk e meriton rënien nga Superliga", ka thënë Ymeri



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Portieri i Drenicës, Arion Ymeri, është optimist se klubi kuqezi nuk do të rrezikohet nga rënia në Ligën e Parë pasi në radhët e veta ka futbollistë cilësorë që do t'i ndihmojnë në mbetjen në IPKO Superligë. Portieri ka thënë të martën për "Epokën e re" se Drenica duhet t'u qasat ndeshjeve të ardhshme me seriozitet më të madh. "Rreziku ekziston, por e mira është se ende kemi katër pikë para zonit të rrezikshëm dhe, pavarësisht prej kundërshtarëve që i kemi, ne duhet t'u qasemi lojërave një nga një dhe të fitojmë sa më shumë pikë kur kanë mbetur edhe gjashtë. Besoj fuqishëm në bashkëlojtarët e mi sepse të gjithë kanë cilësi dhe ky ekip, me kualitetin që ka, normalisht se nuk meriton rënien nga Superliga", ka thënë Ymeri. Një fakt interesant që e ka përcjellë skuadrën kuqezi është se rezultatet

pozitive i ka regjistruar si mysafir, derisa si vendës në ndeshjet e fundit ka çaluar duke humbur ndaj rivalëve në garën për mbijetesë. Ymeri ka shprehur mendimin se këto dështime nga Klubi i Drenicës kanë ardhur edhe si pasojë e nënçmimit të kundërshtarëve. "Si mysafir në tri lojërat e fundit i kemi pesë pikë nga kundërshtarët të fortë siç janë Ballkani, Llapi, Feronikeli, por me kundërshtarë direkt që kemi për mbijetesë si Flamurtari dhe Trepça '89, kemi pritur ta kemi më të lehtë, por na ndodhi e kundërta dhe u vlerësua se për të fituar një ndeshje duhet të jepet maksimumi. Ndoshta i kemi nënvlerësuar këta kundërshtarë dhe kjo na ka kushtuar", ka deklaruar ai. Ndeshjen e radhës në Superligë, Drenica e zhvillon kundër Prishtinës në stadiumin "Fadil Vokrri". Për këtë ndeshje portieri kuqezi ka shprehur optimizëm se mund të nxirret një rezultat pozitiv. "Në Prishtinë do të shkojmë shumë të motivuar për rezultat pozitiv

sepse duhet të reagojmë nga kjo humbja e fundit që në të vërtetë ishte shumë e dhimbshme për ne. Drenica nuk dorëzohet para asnjë kundërshtari dhe synojmë pikë në përballjen e radhës", ka përfunduar Ymeri. Aktualisht Drenica zë pozitën e tetë me 35 pikë të grumbulluara, kurse ky klub arriti edhe deri në gjysmëfinalen e Kupës së Kosovës ku u eliminua nga Prishtina.

IPKO SUPERLIGA - JAVA E 28-T

Të premten takohen:
17:00 Vushtrria - Flamurtari
20:00 Prishtina - Drenica

Të shtunën takohen:
17:00 Feronikeli - Gjilani
17:00 Dukagjini - Ballkani

Të dielën takohen:
17:00 Llapi - Drita
17:00 Ferizaj - Trepça '89

SHKURT

Liria merr përkrahje nga Komuna e Prizrenit

Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prizrenit, Emilia Rexhepi, ka pritur drejtuesit e KF Liria. Kryetari Qemal Krasniqi, drejtori Erxhan Dana, anëtari i bordit Durak Thaçi dhe kapiteni Robert Gjeraj e kanë njoftuar Rexhepin për vështirësitë dhe nevojat që ka klubi. Drejtoresha e DKRS-së ka premtuar se do ta shtojë përkrahjen për klubin si në mbështetje financiare përmes subvencioneve, po ashtu edhe në infrastrukturë.

"Tuttosport": Tri klube italiane interesohen për Mërgim Vojvodën

Mërgim Vojvoda mund të largohet nga Standard Liege në afatin kalimtar veror vetëm një vit pasi iu bashkua klubit elitari belg. Falë paraqitjeve të mira këtë edicion, mbrojtësi nga Kosova ka rënë në shënjestër të disa klubeve italiane. "Tuttosport" raporton se Fiorentina, Lazio dhe Torino kanë shprehur interesim për reprezentuesin e Kosovës. Vlera e Vojvodës në tregun e transferimeve llogaritet të jetë tetë milionë euro.

Juve sërish në garë për Kumbullën

Juventusit sërish është futur në garë për qendërmbrojtësin shqiptar, Marash Kumbulla. Qendërmbrojtësi shqiptar po shkëlqen në fanellën e Veronës dhe interesimi i klubeve të njohura për kartonin e tij është i madh. Futbollisti kuqezi kërkohet edhe nga Interi dhe Lazio.

Muriqi në formacionin e javës në Turqi

Vedat Muriqi është përfshirë në formacionin e javës në Superligën e Turqisë. Reprezentuesi i Kosovës po vazhdon të shkëlqejë në ligën turke, kurse në fundjavën e kaluar e ka ndihmuar Fenerbahçen që t'i marrë tri pikë të reja. Muriqi ka shënuar një gol dhe ka dhuruar një asistim në fitoren 3-2 ndaj Yeni Malatyasporit. Me atë gol e asistim të bërë, prizrenasi ka shkuar në kuotën e 15 golave dhe pesë asistimeve deri më tani në këtë edicion.

Napoli e dëshiron Rashicën për sezonin e ardhshëm

Skuadra e Napolit do të tentojë ta transferojë Milot Rashicën. Reprezentuesin e Kosovës e dëshiron edhe skuadra e Leipzigut si zëvendësim për Timo Wernerin. Rashica në verë pritet të largohet nga Werder Bremenit, por ky klub kërkon të paktën 25 milionë euro për shërbimet e ish-futbollistit të Vushtrrisë. Më herët interesim për 24-vjeçarin kanë shfaqur edhe Hertha, Milani dhe Liverpoolet.

Dy yjet e NBA-së konfirmohen pozitivë me Covid-19

ORLANDO, 30 QERSHOR - De Andre Jordan dhe Spencer Dinwiddie, të dy lojtarë të skuadrës së Brooklyn Nets, kanë rezultuar pozitivë me koronavirus. Ata kanë konfirmuar lajmin përmes postimeve në rrjetet sociale.

Ditët e fundit të gjithë lojtarët e NBA-së i janë nënshtruar testit të parë dhe rreth 15 lojtarë kanë dalë pozitivë, por pa përmendur emra. Këto teste që do të kryhen në vazhdimësi bëhen për shkak të rikthimit të kampionatit më

30 korrik, i lënë në mes që në mars. "Mësova se kam rezultuar pozitiv me Covid-19 kur kam shkuar në market. Për pasojë, nuk do të jem në Orlando kur të rinisë sezoni", ka thënë DeAndre Jordan. Ndërsa Dinwiddie ka

shkruar: "Duhej të ishim një nga ekipet që do të nisim më herët grumbullimin në Orlando, por vazhdojmë të jemi në Nju Jork. Tani, për fat të keq, jam pozitiv. Kam pasur simptoma, temperaturë dhe dhimbje në gjoks.



Nuk e di nëse do të jem apo jo në Orlando".

Lewandowski kryeson renditjen për 'Topin e Artë'

LONDËR, 30 QERSHOR - Sulmuesi i Bayern Munchenit, Robert Lewandowski, e kryeson renditjen aktuale në garën për "Topin e Artë", ndërsa sulmuesi i Juventusit, Cristiano Ronaldo, dhe ai i Barcelonës, Lionel Messi, mbeten në pozitën e dytë dhe të katërt. Robert Lewandowski e mbylli sezonin 2019/20 të Bundesligës si kampion dhe me 34 gola të shënuara në 31 ndeshjet, duke e fituar kështu për herë të pestë çmimin për golashënuesin më të mirë. Si rezultat i kësaj, "Goal" e ka radhitur atë si futbollistin më favorit për ta fituar Topin e Artë momentalisht, çmim ky që do të ndahet në dhjetor. Top-



pesëshja e kësaj gare Kevin de Bruyne, Messi dhe kompletetohet nga Ronaldo, Thomas Muller.

RENDITJA AKTUALE NË GARËN PËR "TOPIN E ARTË":

20. Ciro Immobile (Lazio & Itali)	10. Jadon Sancho (Borussia Dortmund & Angli)	1. Robert Lewandowski (Bayern Munchen & Poloni)
19. Josip Iliqij (Atalanta & Slloveni)	9. Kylian Mbappe (Paris Saint-Germain & Francë)	2. Cristiano Ronaldo (Juventus & Portugali)
18. Timo Werner (RB Leipzig & Gjermani)	8. Erling Haaland (Borussia Dortmund & Norvegji)	3. Kevin De Bruyne (Manchester City & Belgjikë)
17. Alphonso Davies (Bayern Munich & Kanada)	7. Neymar (Paris Saint-Germain & Brazil)	4. Lionel Messi (Barcelona & Argjentinë)
16. Trent Alexander-Arnold (Liverpool & Angli)	6. Karim Benzema (Real Madrid & Francë)	5. Thomas Muller (Bayern Munchen & Gjermani)
15. Serge Gnabry (Bayern Munich & Gjermani)	5. Thomas Muller (Bayern Munchen & Gjermani)	6. Karim Benzema (Real Madrid & Francë)
14. Bruno Fernandes (Manchester United & Portugali)	4. Lionel Messi (Barcelona & Argjentinë)	7. Neymar (Paris Saint-Germain & Brazil)
13. Sadio Mane (Liverpool & Senegal)	3. Kevin De Bruyne (Manchester City & Belgjikë)	8. Erling Haaland (Borussia Dortmund & Norvegji)
12. Jordan Henderson (Liverpool & Angli)	2. Cristiano Ronaldo (Juventus & Portugali)	9. Kylian Mbappe (Paris Saint-Germain & Francë)
11. Kai Havertz (Bayer Leverkusen & Gjermani)	1. Robert Lewandowski (Bayern Munchen & Poloni)	10. Jadon Sancho (Borussia Dortmund & Angli)

Përquku: Mundësi e artë të luajmë në arenën ndërkombëtare

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Ideja e formimit të Përfaqësueses A në konkurrencën e femrave po mirëpritet nga komuniteti i gjerë i basketbollit në Kosovë. Propozimi duhet të miratohet edhe në Bordin e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Ideja është që Kosova të marrë pjesë në vitin e ardhshëm në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla, ku marrin pjesë vende me cilësi të përafërt me Kosovën. Një nga basketbollistët më me përvojë dhe më shumë trofe në basketbollin e femrave është Arbnore Përquku. Edhe ajo e përkrah idenë e formimit të Përfaqësueses A të femrat. "Sigurisht se e mirëpresim këtë ide. Që 20 vjet luaj basketboll dhe do të ishte shumë mirë që të luaj edhe me shtete evropiane dhe të kem përvojë në arenën ndërkombëtare në karrierën time", ka thënë Përquku përfaqësueses A të femrat. "Ideja është e qëlluar, sepse u jepet mundësia, si neve që kemi përvojë, por është një



mundësi e artë edhe për gjeneratat e reja", ka shtuar ajo. Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për

pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Europe do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha Federatat Nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

SHKURT

Pjaniqi kalon te Barcelona

Pas zyrtarizimit të transferimit të Arthurit te Juventusit, tashmë vjen edhe lajmi për kalimin e Miralem Pjaniqi te Barcelona. Klubi blaugrana do të paguajë 60 milionë euro dhe 5 milionë euro në formë bonusesh. Futbollisti boshnjak do të nënshkruajë një kontratë për katër sezone, teksa klauzola e tij arrin shifrën e 400 milionë eurove. Ai do të qëndrojë deri në fund të sezonit te skuadra torineze.

Shtyhen për vitin tjetër 'Davis Cup' dhe 'Federations Cup'

Dy ngjarjet më të mëdha ekipore për shtete në tenis, "Davis Cup" për meshkuj dhe "Federations Cup" për femra, këtë vit nuk do të zhvillohen për shkak të koronavirusit. Federata Ndërkombëtare e Tenisit (ITF) ka marrë vendimin për t'u shtyrë këto dy turne në vitin 2021. Ndeshjet e fazës finale të Federations Cup për femra do të zhvillohen në Budapest të Hungarisë në prill të vitit të ardhshëm, ndërsa ato të Davis Cup për meshkuj do të zhvillohen në Madrid në nëntor të 2021-shit. Ideja e ITF-së ishte që këto dy turne t'i zhvillonte në fund të këtij viti, por është e pamundur. Sidomos në rast se rinisin turnetë e mëdhenj dhe kalendari do të jetë i ngjeshur. Këto dy turne nisën eliminatorët në shkurt të këtij viti, por u ndërprejnë.

Roma fiton garën ndaj Interit për Cavanin

Sulmuesi Edison Cavani nuk do të transferohet në Atletico Madrid, por e ardhmja e tij pritet të jetë në Itali. Sulmuesi i PSG-së është duke u kërkuar që një kohë të gjatë nga Interi, kurse tash garë i është shtuar edhe Roma. Skuadra nga kryeqyteti italian duket se do ta fitojë garën për transferimin e sulmuesit për faktin se i ka garantuar se do të jetë ndër lojtarët më të paguar në klub. Nëse Cavani pranon ofertën e Romës, ky transferim do të bëhet me parametra zero, sepse sulmuesit i përfundon kontrata me klubin francez.

Kurzawa rinovon kontratën me PSG-në

Layvin Kurzawa edhe zyrtarisht do të qëndrojë te Paris Saint-Germaini. Mbrojtësi francez ka arritur marrëveshje me parisienët që ta vazhdojë kontratën edhe për katër vjetet e ardhshëm. Kurzawa do të qëndrojë në Paris deri në vitin 2024, duke shuar zërat se ai do të largohet nga klubi. Ka kohë që raportohet nga mediat ndërkombëtare se lojtari do të largohej si lojtar i lirë nga PSG-ja, pasi kontrata do t'i skadonte më 30 qershor. Por, klubi francez konfirmoi se lojtari ka nënshkruar kontratë katërvjeçare dhe do të jetë pjesë e projekteve të tij.

Bruce: De Bryune vitin tjetër do të luajë për Newcastle

Mesfushori i Manchester Cityt, Kevin De Bruyne, është një nga më të mirët në botë dhe statistikat e tij me fanellën e "Qytetarëve" janë për t'u admiruar. Lojtari i kombëtares belge ka dhuruar më shumë se 80 asistime qëkur u transferua në "Etihad Stadium" nga Wolfsburg. Edhe në ndeshjen çerekfinale të Kupës FA, De Bruyne shkëlqeu kundër Newcastle dhe shënoi golin e parë të sfidës me penallti. Një paraqitje fantastike që i bëri përshtypje edhe teknikut të vendësve, Steve Bruce, i cili ndërhyri gjatë kohës kur mesfushori po jepte një intervistë pas ndeshjes. "Ai do të qëndrojë këtu. E keni ekskluzive nga unë. Kevin është lodhur me Cityn dhe në sezonin tjetër do të luajë për Newcastle", ka thënë Bruce.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-MALISHEVË

Zyra e Personelit

Nr.01/
Më:30/06/2020

Në mbështetje të dispozitave të nenit 18 dhe nenit 27, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5 i të Rregullores Nr. 21/2012, për Avancim në Karrierë të Nëpunësve, si dhe nenit 16, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.7, të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM

I. DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTERE

1.(Një) Udhëheqës i sektorit për Gjeodezi

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara: Diplomë universitare, drejtimi i gjeodezisë.

Përvojë pune: 4 vite përvojë pune profesionale;

-Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;

-Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës i karrierës.

Koeficienti: 7.5

Kodi i vendit të punës KG/020

Numri i referencës:

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Udhëheqë punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për sektorin

-Menaxhon stafin e sektorit, dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, si dhe ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit;

-Në bashkëpunim me drejtorin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;

-Siguron matjet dhe incizimet gjeodezike të të gjitha profileve dhe grumbullimin e të dhënave të pasurisë së paluajtshme në terren me qëllim të regjistrimit në sistemin e kadastrit dhe rregullimin e kufijve të pasurive të paluajtsh

-Harton detyrat projektuese për objektet e infrastrukturës pas dhënies së kushteve urbanistike nga sektori i urbanizimit dhe rekomandon dinamikën e kryerjes së punëve, realizimit të projekteve;

-Siguron përgatitjen e dokumenteve e nevojshme për infrastrukturën rrugore përfshirë incizimet gjeodezike të të gjitha profileve dhe paraqet në mënyrë grafike rrugët, kanalizimin, rrjetin e ujësjellësit, rrjetin elektrik, parkingjet dhe shtigjet e këmbësoreve;

-Udhëzon ekipin në përgatitjen e elaboratit kadastral, planeve, foto-skicave, si dhe përgatitjen e terrenit për rilevim dhe matje si dhe aprovon të gjitha dokumentet që lëshohen nga ky sektor;

-Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara;

Dokumentet e kërkuara

-Diploma universitare

-Letërnjoftimi (fotokopje);

-Certifikata e lindjes;

-Certifikata për trajnimet e kryera;

-Dëshmi që nuk është nën hetime

-Vërtetimin e përvojës së punës;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve të KK- Malishevë**. Konkursi do të publikohet në të përditshmen "Epoka e re", në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-MALISHEVË

Zyra e Personelit

Nr.01/
Më:30/06/2020

Në mbështetje të dispozitave të nenit 18 dhe nenit 27, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5, i të Rregullores Nr. 21/2012, për Avancim në Karrierë të Nëpunësve, si dhe nenit 16, paragrafi 1, pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.7, të Rregullores për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM

I. DREJTORIA PËR EKONOMI, FINANCA DHE BUXHET

1.(Një) Udhëheqës i Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara: Diplomën e Fakultetit Juridik/Ekonomik apo ndonjë Fakultet që lidet me këtë vend të punës

Përvojë pune: 4 vite përvojë pune profesionale;

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës i karrierës.

Koeficienti: 7.

Kodi i vendit të punës RB/040

Numri i referencës: RN0006040

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Përpilon Programin dhe Planin e punës

-Është përgjegjës për sektorin e vet.

-Organizon dhe koordinon kryerjen e punëve në sektor.

-Bënë unifikimin e planit vjetor të punës dhe mbikëqyrë realizimin e tij, koordinon punët në hartimin e informativ, raporteve, analizave et

-Është përgjegjës për kryerjen e punëve me sukses në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

-Jep aplikacionet udhëzimet dhe këshilla të nevojshme qytetarëve të interesuar për regjistrim të biznesit

-Pranon aplikacionet dhe bën regjistrimin e bizneseve të reja brenda territorit të komunës, në harmoni me rregullat dhe kriteret e përcaktuara me aktet ligjore, në fuqi, të RKS

-Bën licencimin e të gjitha bizneseve duke përfshirë bizneset e cilësuar si: shoqërore, shtetërore, private.

Dokumentet e kërkuara

-Diploma universitare

-Letërnjoftimi (fotokopje);

-Certifikata e lindjes;

-Certifikata për trajnimet e kryera;

-Dëshmi që nuk është nën hetime

-Vërtetimin e përvojës së punës;

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve të KK- Malishevë**. Konkursi do të publikohet në të përditshmen "Epoka e re", në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-MALISHEVË

Zyra e Personelit

Nr.01/
Më:30/06/2020

Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

I. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

1.(Një) Zyrar për Arkiv

Kualifikimi i kërkuar: Diplomë Universitare Fakulteti i Administratës publike, Fakulteti i Historisë- Arkivistika, pa përvojë ose shkollë e lartë dhe së paku dy (2) vite përvojë pune nga fushat e lartpërmendura

Koeficienti: 6.

Kodi i vendit të punës AK/150

Numri i referencës: RN0006039

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;

-Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;

-Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;

-Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;

-Mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;

-Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;

-Kordinon punën me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postes, shkresave jashtë dhe brenda institucionit;

-Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Dokumentet e kërkuara

-Diploma universitare;

-Letërnjoftimi (fotokopje);

-certifikata e lindjes;

-certifikata për trajnimet e kryera;

-Dëshmi që nuk është nën hetime

-Vërtetimin e përvojës së punës;

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve të KK- Malishevë**.

Konkursi do të mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshme: "Epoka e re", në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:171 /1
Dt: 30.06.2020

Në bazë të nenit 23 i Ligjit nr. 06/L-113, Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, si dhe Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

Departamenti: Administratë Financa
Paga bruto: 423.85 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për financa (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: gjatë (6) mujore

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ben përgatitjen e lëndëve për pagesë, si dhe përgatitë raporte lidhur me shpenzimin e buxhetit;
- Ben barazimin e shpenzimeve për çdo muaj me raportet e Free Balance.
- Përgatit raporte tremujore, gjashtëmujore mbi shpenzimet buxhetore në bazë të LMFP-së;
- Ndihmon ne Hartimin ne planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;
- Mbështet njësinë buxhetore në zbatimin e buxhetit gjatë vitit fiskal dhe jep propozime për kërkesat e arritura buxhetore;
- Kryen edhe punë tjera profesionale në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
- Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e financave, QEK - AAAPARr – MASHr, MF;
- Përgjegjës për raportim të punës se kryer;
- Puna juaj do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret për menaxhimin e financave publike aktuale të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:

- Diplome universitare, drejtimi ekonomik, apo të ngjashme,
- 2 vite përvojë profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e buxhetit dhe financave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe vlerësuese;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit);

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 5 ditë kalendrike nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në zyrat e Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (Ndërtesa MASHr-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p. n, Prishtinë), duke filluar nga ora 8.00 deri në orën 16.00 po ashtu aplikacionet e plotësuar, duhet të dërgohen në këtë adresë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E JUNIKUT MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Zyra e Kryetarit
Datë:01.07.2020

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 11, paragrafi 1, neni 18 paragrafi 1 dhe 3, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbim Civil, neni 3 paragrafi 1 dhe 2 Komuna e Junikut shpall këtë:

KONKURS I BRENDSEHM

Pozita I.

Institucioni:	Komuna e Junikut
Drejtoria:	Administratë e përgjithshme
Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativ dhe Logjistik
Kategoria funksionale/Grada:	Koeficienti- 8.5
